# GAZETA SHQIPTARE






Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com






Viti XXIII - Nr. 7339 E martë 31 Tetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)


Reportazhi i Ditës

Nga MONIKA STAFA

## Berlin 'Dream Liner' - Një kullë në pyll



Në vitin 1892, një grup i spikatur berlinezësh në jetën shoqërore të qytetit, i propozuan kaiserit gjerman, hapjen e një ekspozite ndërkombëtare ...


Vijon në faqen 20


Opinioni i Ditës

Nga VALBONA NATHANAILI

## "Kanabizimi" i universiteteve publike



Përpara disa ditësh, në sallën e Universitetit të Arteve (universitet publik), me mbështetjen e ambasadës austriake në Tiranë, Orkestra Simfonike e Radio ...


Vijon në faqen 21




Kush është Helidon Bendo, zëvendësi i tij

# Drejtoi për 5 vjet SHISH, dorëhiqet Ajazi. 30 minutat e takimit Rama-Meta

Berisha: Kishin dokumente përvëluese për Ramën. Kreu i PD, Basha: Iku nga presioni politik

Drejtori i Shërbimit Informativ Shtetëror (SHISH), Visho Ajazi Lika ka dhënë dorëheqjen pas 5 vitesh në krye të këtij institucioni. Burime zyrtare nga Kryeministria dhe Presidenca dje bënë me dije se Visho Ajazi Lika e ka dhënë dorëheqjen përfundimtare që të premten. Ndërkohë që në vend të tij ...


Në faqet 2-3


LISTA E PARE ME EMRAT E TRASHEGIMTAREVE QE PERFITOJNE DEMSHPERBLIMIN

# ISH-TE PERNDJEKURIT, 3 MIJE PERFITUESIT

Ministria e Financave publikon emrat e personave që përfitojnë këstin e parë dhe të dytë. Lista me dokumentet që duhet të plotësojë gjithsecili për të marrë paratë




(Në foto) Ish-të përndjekur në protestë


Në faqet 14-17


REAGIMET

## Vetingu nis punë, ambasadori Lu: Dritë shprese për Shqipërinë


Në faqen 6


PARALAJMERIMI

## Kryeministri: Pse nuk financojmë asgjë për Akademinë e Shkencave


Në faqen 7


SITUATA PAS VENDIMIT

## Të verbrit dhe paraplegjikët nuk marrin shtesën në pension


Në faqen 12


GJIROKASTER

## Nxënës e prindër ankohen: Bëjmë 18 kilometra në këmbë për në shkollë


Në faqen 9


FAMILJA: DUAM TE DIME KU PREHET



## Amaneti Riza Danit: Më varrosni pranë vajzës, me shpresë vdes si burrë


Në faqet 10-11


Prokuroria merr 1800 faqe të tjera përgjimesh të Habilajve, s'përmendet ish-ministri

# Saimir Tahiri: Nuk pranoj gjyq politik

*"Askush nuk mund të më mbyllë karrierën politike"*

Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri hapi dyert e shtëpisë së tij për gazetarin Sokol Balla, në emisionin "Top Story" pas kontrollit të bërë nga policia gjyqësore, pak ditë më parë. I pyetur për akuzat ndaj tij, të ngritura nga Prokuroria dhe si e pritën njerëzit e tij të afërt,



Tahiri tha se familja e priti me stres të madh. Ai shtoi se të bësh politikë në Shqipëri ka kosto, megjithatë politika nuk i është neveritur akoma. Ai deklaron se nuk ka imunitet dhe se po hetohet nga Prokuroria si i tillë dhe se është i vetmi deputet ...


Në faqet 4-5

# KREU I SHISH
## REAGIMET

Zbulohet formulari i dekriminalizimit, kreu i ri i SHISH ka dy identitete

# Drejtoi institucionin e spiunazhit për 5 vjet, jep dorëheqjen Visho Ajazi Lika

## *Takim 30 minuta, Edi Rama i propozoi Metës, 46-vjeçarin Helidon Bendon*



Ish-drejtori i SHISH, Visho Ajazi



Drejtori i propozuar i SHISH, Helidon Bendo

**PROPOZIMI**
Mesditën e djeshme, kryeministri Edi Rama zhvilloi një takim 30 minutësh me Presidentin e Republikës, Ilir Meta. Gjatë këtij takimi, Rama i paraqiti propozimin për lirim të Drejtorit të Shërbimit Informativ, Visho Ajazi, dhe emërim në këtë detyrë të zv.drejtorit të Shërbimit Informativ, Helidon Bendo".



Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH

**TIRANË**

Drejtori i Shërbimit Informativ Shtetëror (SHISH), Visho Ajazi Lika ka dhënë dorëheqjen pas 5 vitesh në krye të këtij institucioni. Burime zyrtare nga Kryeministria dhe Presidenca dje bënë me dije se Visho Ajazi Lika e ka dhënë dorëheqjen përfundimtare që të premten. Ndërkohë që në vend të tij është propozuar Helidon Bendo, i cili ka mbajtur detyrën e zëvendësdrejtorit të SHISH që nga prilli i vitit 2016. Mësohet se pasi Visho Ajazi Lika ia ka paraqitur zyrtarisht largimin nga detyra kryeministrit Edi Rama, ky i fundit i propozoi Presidentit Ilir Meta emrin e ri të drejtorit të SHISH. Kjo, gjatë një takimi të zhvilluar mesditën e djeshme. Vetë e zyra e shtypit pranë kryeministrit ka dhënë detaje nga ky takimi i Ramës me Metën. Në njoftimin e shpërndarë për mediat thuhet: "Kryeministri Edi Rama zhvilloi një takim 30-minutësh me Presidentin e Republikës, ku paraqiti propozimin për lirim të drejtorit të Shërbimit Informativ, Visho Ajazi dhe emërimin në këtë detyrë të zv.drejtorit të Shërbimit Informativ, Helidon Bendo". Gjithashtu, në këtë njoftim thuhet se "propozimi i kryeministrit për lirim dhe emërim në krye të Shërbimit Informativ Shtetëror erdhi pas dorëheqjes nga detyra të drejtorit të këtij shërbimi, të cilën kryetari i qeverisë e mirëpriti duke e falënderuar zotin Visho Ajazi për kontributin e tij". Takimi mes kryeministrit dhe presidentit ishte i pari që prej betimit të qeverisë së re. Visho Ajazi Lika u emërua në detyrën e drejtorit të SHISH në gusht të vitit 2012 nga kryeministri Sali Berisha dhe me dekret të Bujar Nishanit, por ligji përcakton se mandati i drejtorit të Shërbimit Informativ është i pakufizuar, duke lënë vetëm dy opsione për largimin e tij: ose me vendimmarrje personale të drejtorit të SHISH-it, ose me konsensus Kryeministri-Presidencë. Sipas ligjit, shefi i Shërbimit Informativ propozohet nga kryeministri dhe dekretohet nga presidenti. Helidon Bendo duhet të marrë dekretin e Presidentit të Republikës përpara se të ulet në karrigen e drejtorit të ri të SHISH.

**DREJTORI I RI I SHISH**

Kreu i ri i SHISH është emëruar Helidon Bendo pas dorëheqjes së Visho Ajazi Likës. Ai u emërua si zv.drejtor i SHISH në prill të vitit 2016. Nga plotësimi i formularit të vetëdeklarimit për ligjin e dekriminalizimit, Bendo rezulton se ka dy identitete. Ai mban edhe emrin Johan Bendo. Këtë identitet, ai e përdorte gjatë qëndrimit në Greqi. Në formularin e vetëdeklarimit, Helidon Bendo sqaron se Johan është emri i pagëzimit të tij. 46-vjeçari ka eksperiencë 21-vjeçare në SHISH ku ka mbajtur detyra të ndryshme si: inspektor terreni, kryetar dege, drejtor drejtorie në disa qarqe të vendit dhe drejtor drejtorie në AQ. Bendo ka lindur më datën 12 maj 1971 në qytetin e Korçës. Ai është i martuar dhe ka dy fëmijë. Ai është diplomuar në vitin 1993 për matematikë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, ka një master në studime për sigurinë, si edhe një trajnim tremujor në fushën e sigurisë pranë Universitetit "George Town" në SHBA.

**ISH-KREU I SHISH DHE SKANDALET**

Visho Ajazi Lika ka drejtuar për 5 vite institucionin më të rëndësishëm të spiunazhit në vend që kur u emërua nga Sali Berisha, në vitin 2012-të. Por nëse bëjmë një bilanc të detyrës së tij, ajo është e mbushur me të papritura dhe skandale, siç ishte ai i përgjimeve. Pasi Ilir Meta u bashkua me Edi Ramën në 2013-ën, Komisioni i Sigurisë zbuloi se Visho Ajazi Lika ishte urdhëruar nga Sali Berisha që të përgjonte. U zbulua se një numër i madh politikanësh dhe 25 deputetë të mazhorancës ishin përgjuar, mes tyre edhe Edi Rama dhe Ilir Meta. Po ashtu edhe Saimir Tahiri, Erion Veliaj, Vangjel Dule, Tom Doshi, Ben Blushi, Taulant Balla etj. Ndërsa në PD, veç Lulzim Bashës, të përgjuar figuronin edhe Astrit Patozi, Ilir Rusmali dhe Sokol Olldashi. Pas këtij skandali, Komisioni i Sigurisë ngriti një komision hetimor, por nuk u arrit në asnjë konkluzion. Në vitin 2014, Visho Ajazi Likës i shpërtheu një tjetër skandal. Ai u thirr në Komisionin e Sigurisë për të raportuar, por doli se i kishte skaduar certifikata e sigurisë. Rezultoi se kreu i SHISH kishte 6 muaj që nuk kishte certifikatë sigurie, sikundër përcakton ligji në rastet e zotërimit të dokumenteve që konsiderohen si sekret shtetëror. Pas marrjes së detyrës, Visho u akuzua gjithashtu se e mbushi institucionin me agjentë të ish-SHIK të Bashkim Gazidedes.

## Ja çfarë tha kryeministri katër ditë më parë për Visho Ajazi Likën

**TIRANË** - Dorëheqja e kreut të Shërbimit Informativ Shtetëror, Visho Ajazi Lika erdhi vetëm pak ditë pas skandalit ku u përfshi ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri, emri i të cilit u përmend në përgjimet e Habilajve të trafikut të drogës. Në lidhje me informacionet që ky i fundit ka dhënë për këtë rast, ka folur publikisht edhe kryeministri Edi Rama, mbrëmjen e 27 tetorit i ftuar në "Zonë e Lirë". Ai tha se kreu i SHISH nuk i kishte raportuar asnjë informacion zyrtar në lidhje me këtë çështje.



Kryeministri Edi Rama

**Çani: A ju solli ndonjë informacion SHISH-i, Shërbimi Informativ për Habilajt dhe lidhjen e tyre me Tahirin, ju jeni kryeministër dhe me siguri duhet ta dini?**

**Rama:** Më lejoni t'ju kujtoj se çështjet e shërbimit sekret janë çështje të shërbimit sekret. Kësaj pyetjeje mund t'i jap përgjigje të prerë, asnjë, asnjëherë, s'më ka sjellë asnjë informacion zyrtar mbi asnjë lidhje të ministrit të Brendshëm me asnjë grup kriminal.

## Dorëheqja e kreut të SHISH, Lubonja: I është bërë presion

**TIRANË** - Analisti Fatos Lubonja ka komentuar dorëheqjen e kreut të Shërbimit Informativ Shtetëror, Visho Ajazi Lika. I ftuar në rubrikën "Opinion" në "News 24", Lubonja tha se ai nuk duhet ta jepte dorëheqjen në këtë moment dhe sipas tij, dorëheqja tregon se kreu i SHISH ka qenë në presion nga politika. "E para gjë që më vjen në mendje është se nuk duhet të jepte dorëheqjen një njeri kaq i rëndësishëm në këtë moment. E kam fjalën për çështjen 'Tahiri'. Rama tha se SHISH nuk i ka çuar atij asnjë informacion zyrtar për lidhjet e Tahirit me Habilajt. Po të isha unë në vend të opozitës, do thërrisja komision për këtë çështje. Pra, çfarë bën SHISH, pse i paguajmë ne ata? Ajo që të lë të mendosh është se Visho Ajazi Lika ishte në të gjitha presionet dhe se nuk ka bërë punën si duhet. Opozita thotë se është hequr pas presioneve të qeverisë. Po të dëgjosh Ramën, Visho Ajazi Lika ishte në rregull. Në Shqipëri mjafton që hap rrugën dhe je i shpëtuar. Ne duam transparencë dhe të kërkohet llogari pse nuk ka dhënë shërbimet e duhura për kryeministrin dhe presidentin. Kemi një kapje të institucioneve nga Rama", - tha Lubonja. Ndër të tjera, ai komentoi edhe kreun e ri të SHISH, Helidon Bendo për të cilin tha se mund të jetë emëruar nga dikush.

REDAKSIA: **Redaktor i Politikës:** Tedi BLUSHI, **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Dossier:** Iv Kaloçi, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli,
***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI. ADMINISTRATA**: Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu*:** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com*, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



“Kreu i SHISH, prej dy vitesh ai ishte halë në sytë e Edi Ramës”

# Dorëheqja e Visho Ajazit, Basha: Pasojë e presioneve politike

## "Saimir Tahiri duhet të arrestohet"

Valentina Madani



Kreu i opozitës, Lulzim Basha

Kreu i opozitës, Lulzim Basha shigjetoi dje kryeministrin Edi Rama se fshihet ai pas dorëheqjes së kreut të SHISH-it, Visho Ajazi, pasi sipas tij, "ai ishte halë në sytë e Edi Ramës". Basha nuk nguroi ta quante këtë vendim si pasojë e presioneve politike. Në përfundim të mbledhjes së grupit parlamentar, Basha përmendi se prej 2 vitesh SHISH është halë në sytë e narko-shtetit dhe të Edi Ramës, pasi ka hartuar raporte që policia është e përfshirë në kultivimin dhe trafikimin e drogës". Kryetari i opozitës, Lulzim Basha tha se dorëheqja e Visho Ajazi Likës nga drejtimi i Shërbimit Informativ të Shtetit vjen në një kohë kur raportet e shërbimit sekret konfirmojnë përfshijnë policinë në kultivimin dhe trafikimin e drogës. "Natyrisht nuk kam informacione konkrete. Por një gjë është e sigurt; një Shërbim Informativ i cili harton raporte për përfshirjen e Policisë në kultivimin dhe trafikimin e drogës, siç ka bërë SHISH prej dy vitesh, është halë në sytë e narko-shtetit dhe të Edi Ramës. Ndaj, nuk mund të ketë konkluzion tjetër përveçse presionit politik. Kjo tregon që narko-shteti është në panik total dhe po bën gjithçka për të mbyllur aferën e Samir Tahirit", u shpreh z.Basha. Sipas tij, kjo tregon që narko-shteti është në panik total dhe po bën gjithçka për të mbyllur aferën e Tahirit, por e kundërta do të ndodhë, kësaj afere do t'i shkohet deri në fund. Basha shprehu bindjen se ish-ministri i Brendshëm nuk do t'i shpëtojë drejtësisë. "Saimir Tahiri nuk do t'i shpëtojë drejtësisë, kjo është e sigurt. Bota perëndimore nuk do ta lerë Shqipërinë në këtë betejë jetike për të përmbysur kupolën mafioze në pushtet. Nuk do lejojë që Shqipëria të kthehet në një narko-shtet të sunduar nga bandat, ndaj jo vetëm kjo çështje nuk do të mbyllet, por të tjera do të hapen në ditët në vijim", u shpreh kreu i PD-së. Po ashtu, Basha përsëriti kërkesën që kryeministri Rama të mos ushtrojë presion ndaj prokurorisë në lidhje me Saimir Tahirin. Sipas kryedemokratit, ish-ministri i Brendshëm nuk do t'i shpëtojë drejtësisë. "Kërkesa jonë e pandryshuar që ka edhe mbështetjen e të gjithë botës perëndimore është që Rama të mos ushtrojë presion ndaj prokurorisë dhe të mos përdorë imunitetin parlamentar për të mbrojtur Tahirin nga kërkesat e drejta të prokurorisë. Tahiri duhet të arrestohet. Përdorimi i imunitetit parlamentar për të ndaluar arrestin e Saimir Tahirit bëhet vetëm për të mbrojtur atë dhe bashkëpunëtorët e tij, duke përfshirë Edi Ramën. Bota perëndimore nuk do ta lerë Shqipërinë vetëm në këtë betejë jetike për të përmbysur kupolën mafioze në pushtet. Nuk do të lejojë që Shqipëria në zemër të Europës të kthehet në një narko-shtet, në një shtet të dështuar të drejtuar dhe sunduar nga bandat me lidhje direkte politike me kryeministrin dhe politikanët e tjerë të korruptuar. Ndaj, jo vetëm kjo çështje nuk do të mbyllet, por të tjera do të hapen në ditët në vijim", theksoi z.Lulzim Basha.

## "Çmimi që Vishos iu desh të paguante"

# Berisha: SHISH, dokumente përvëluese për Ramën



Pas dorëheqjes së Visho Ajazit nga kreu i SHISH, vjen reagimi i ish-kryeministrit Sali Berisha. Në një status në faqen e tij të "Facebook"-ut, Berisha flet për 'çmimin' që duhet të paguante Lika në këtë rast, që lidhet me denoncimet e tij në prokurori. Sipas tij, "dorëheqja në kulmim e skandalit të implikimit të Saimir Tahirit në dosjen 'Habilaj' dëshmon tmerrin e Ramës nga dokumentet përvëluese që SHISH mund të dorëzonte në Prokurorinë e Krimeve të Rënda". Mes të tjerash, Berisha doli pro për mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, kërkesë që ishte bërë edhe më parë nga ish-presidenti Bujar Nishani. "Dorëheqja e Ajazit par lens non volens! Drejtori i Shërbimit Informativ, Visho Ajazi, që i shërbeu vendit me integritet dhe përkushtim të veçantë në drejtimin e këtij shërbimi dha papritur dorëheqjen. Dorëheqja është një e drejtë e çdo zyrtari. Por kjo dorëheqje, në kulmim e skandalit të implikimit të Saimir Tahirit, si anëtar kryesor i bandës 'Habilaj' dhe bllokimit të prokurorisë nga Noriega, dëshmon tmerrin e Ramës nga dokumentet përvëluese që Shërbimi Informativ mund të dorëzonte në Prokurorinë e Krimeve të Rënda për dosjen 'Tahiri', por edhe për vetë Ramën e përgjuar aksidentalisht, duke folur me trafikantë dhe për afera të mëdha korruptive si dhe vëllaçko Olsin e kokainës dhe narko-ministra të tjerë", shprehet z.Berisha.

> **DOSJA**
> "I bëj thirrje Komisionit të Sigurisë Kombëtare të marrë me urgjencë nga Shërbimi Informativ të gjithë dosjen e implikimit të Ramës, Olsit dhe ministrave të tij në trafiqe dhe banda kriminale!", tha Berisha.

# Aksioni




**SKANDALI**

Grupi parlamentar i PD-së diskutoi në një mbledhje njëorëshe, pas së cilës Basha deklaroi se në qendër të aksionit politik të opozitës do të mbetet ai që e cilësoi "skandali Tahiri-Rama-Habilaj". Basha tha se si opozita dhe BE e SHBA po i bëjnë thirrje Ramës të mos ushtrojë presion ndaj drejtësisë.



Leonard Olli

# Dorëheqja, PD: Mafia qeveritare po kalon në revansh

Kryetari i këshilltarëve të djathtë në Bashkinë e Tiranës, Leonard Olli e cilësoi dje si "një kambanë e alarmi se mafia qeveritare po kalon në revansh të plotë" dorëheqjen e drejtuesit të SHISH. Nëpërmjet një statusi në "Facebook", ai thotë se është opozita, ajo që duhet të garantojë me çdo kusht mbrojtjen institucionale të funksionarëve të shtetit. "Dorëheqja e drejtuesit të SHISH nuk është vetëm një presion i Ramës ndaj një drejtuesi që nuk pranoi të bëhej vasal i tij e të mbulonte çdo gjurmë të skandalit 'Tahiri', por kambana më e fortë e alarmit se mafia qeveritare po kalon në revansh të plotë. Opozita duhet të garantojë me çdo kusht mbrojtjen institucionale të funksionarëve të shtetit, si e vetmja mënyrë që të shpëtojë rendin kushtetues dhe integritetin funksional dhe individual të çdo njërit prej tyre", shkruan Olli.

# DOSJA "HABILAJ"
## HETIMI

Prokuroria e Krimeve të Rënda pritet të thërrasë përsëri ish-ministrin e Brendshëm

# Dosja "Habliaj", mbërrijnë nga Italia 1800 faqe përgjime bisedash

## *Pas vitit 2015 nuk përmendet emri i Tahirit*




Ina Allkanjari

Dosja me 1800 faqe përgjimesh për grupin kriminal të drejtuar nga Moisi Habilaj, ka mbërritur në prokurorinë shqiptare. Prokuroria e Katanias dhe Antimafias, të cilat dokumentuan veprimtarinë e Habilajve, bën të mundur zbardhjen e përgjimeve mes anëtarëve të bandës. Në to rezulton se pas vitit 2015, emri i ish-ministrit të Brendshëm Saimir Tahiri, nuk përmendet më në bisedat e përgjuara. Periudhë kjo e cila përkon me publikimin e lajmit në Shqipëri, se automjeti "Audi A8" në pronësi të Saimir Tahirit, i është shitur familjarëve Habilaj, duke mos i ndërruar pronësinë. Prokuroria e Krimeve të Rënda pritet të thërrasë për të pyetur përsëri Saimir Tahirin në lidhje me akuzat, të cilat rëndojnë mbi të. Sipas organit të akuzës, janë edhe disa episode të tjera, të cilat ish-ministri duhet të sqarojë në lidhje me përmendjen e emrit të tij në përgjimet e prokurorisë italiane për llogari të dosjes "Habilaj". Ndërkohë edhe autoritetet italiane bëjnë me dije se do të vazhdojnë hetimet për aktivitetin e grupit kriminal, të drejtuar nga vëllezërit Habilaj. Mësohet se mes prokurorisë dhe antimafias italiane janë ngritur disa grupe hetimore të përbashkëta që po hetojnë disa banda të trafikut të kanabisit. Disa ditë më parë Prokuroria e Krimeve të Rënda ka kërkuar nga parlamenti autorizim për heqjen e imunitetit të deputetit Saimir Tahiri, ish-ministër i Brendshëm, si dhe autorizimin për "arrestimin, heqjen e lirisë dhe kontrollin personal e të banesës". Ndaj tij u ngritën akuzat "Trafikim i lëndëve narkotike" e kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal dhe "Korrupsion pasiv i funksionarëve të lartë të shtetit". Nga ana tjetër dosja "Habilaj" vijon të jetë në proces nga pala italiane ku mësohet se mes të arrestuarve si pjesëtarë të grupit, mund të ketë edhe persona që do të përfitojnë statusin e bashkëpunëtorit të drejtësisë. Sakaq të premten ish-ministri i Brendshëm u paraqit në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, ku për 2 orë e 30 minuta qëndroi përballë prokurorëve Vladimir Mara dhe Dritan Prençi duke sqaruar pozicionin e tij në këtë çështje. I shoqëruar nga avokatët e tij, Maks Haxhia dhe Artan Hajdari, Tahiri dëshmoi për lidhjet e tij me grupin e trafikantëve të drogës, Habilaj. Ai i mohoi akuzat se ka ndihmuar grupin e Habilajve në trafikun e kanabisit dhe hodhi poshtë akuzën për korrupsion.


N. 15355/13 R.G.N.R.
N. 13079/14 R.G. G.I.P.

TRIBUNALE DI CATANIA
UFFICIO DEL GIUDICE PER LE INDAGINI PRELIMINARI
ORDINANZA DI APPLICAZIONE DI MISURE
CAUTELARI PERSONALI
-artt. 272 e segg. c.p.p.-

DECRETO DI RIGETTO DELLA RICHIESTA DI APPLICAZIONE DELLA MISURA
CAUTELARE REALE DEL SEQUESTRO PREVENTIVO
-artt. 321-324 c.p.p.-

Il Giudice, dr.ssa Loredana V. K. Pezzino

esaminata la richiesta del PM depositata in data 29.7.2017 di applicazione della misura cautelare della custodia in carcere nei confronti di:

... Albania il 18.01.1978;
... Catania (CT) il 26.02.1971 ed ivi residente alla Via del
... nato a Ragusa il 02.05.1960 e residente a Vittoria

Faksimile e dosjes "Habliaj", të ardhur nga Italia

## Drejtuesit e rinj të burgjeve, Gjonaj: Nuk rrezikohet siguria kombëtare

**TIRANE**- Ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj, ka folur dje lidhur me shkarkimin e drejtorëve të burgjeve në vend. Në një deklaratë për mediat, ministrja është ndalur tek mënyra sesi do zgjidhen drejtuesin e rinj të këtyre institucioneve. E pyetur nëse shkarkimi i drejtorëve cenon sigurinë kombëtare dhe atë në burgje, Gjonaj u shpreh se në ato poste janë komanduar persona profesionistë brenda sistemit, persona të cilët do të shërbejnë brenda një periudhe të shkurtër kohe, derisa nëpërmjet konkurseve të përzgjidhen drejtuesit e rinj. Ministrja Gjonaj falënderoi median, e cila ka luajtur rol të rëndësishëm në rastin konkret. Sipas saj, qytetarët do të sensibilizohen që proceset do të jenë transparente.

## Lëvizja "No Hate" dhe Universiteti Luarasi: Jo, urrejtjes në politikë

Lëvizja "No Hate" dhe Universiteti Luarasi organizuan dje aktivitetin me temë; Jo, urrejtjes në politikë. Kreu i FRPD-së Belind Këllici, deklaroi se opozita është shpresa e vetme e të rinjve për një të ardhme të sigurt larg krimit dhe drogës. "Prej më shumë se 4 vitesh opozita, gazetarët investigativ, rrjetet mediatike prestigjioze ndërkombëtare dhe shoqëria civile, denoncojnë me forcë shndërrimin e Shqipërisë në një hambar droge, mbështetjen që drejtues të lartë të policisë, me urdhër të ish-ministrit të Brendshëm, superministrit të "Rilindjes" dhe bekim të kryeministrit, i japin trafikantëve ndërkombëtarë të drogës. Kemi dëgjuar këto 4 vite se si në vendin tonë po ndërtohen tashmë pista të avionëve të drogës, të cilët për kryeministrin ishin thjesht "mushkonja". Kemi mësuar se radarët në vendin tonë tashmë fiken për t'u krijuar rrugë të lirë skafeve të drogës. Kjo është një plagë e hapur që po shkatërron të sotmen dhe të ardhmen tonë, po e largon çdo ditë e më shumë rininë nga Shqipëria. Unë jam më se i bindur se adresimi dhe ndalimi i përdorimit të gjuhës së urrejtjes në parlament, do të ishte një vlerë e shtuar në jetën e çdo qytetari. Por në mënyrë që t'ia japim këtë vlerë të shtuar qytetarëve tanë, më parë duhet t'i japim arsye që të qëndrojnë në Shqipëri, në vend që të emigrojnë nëpër botë, siguri për të ardhmen e tyre në vend të ofertës rilindase të një Shqipërie kolumbiane, siguri në qeverisje në interesat e qytetarëve në vend të marrjes peng të vendit nga kupolat mafioze të kushërinjve trafikantë, apo vëllezërve në kërkim",-deklaroi z.Këlliçi.

STRATI

Shoqëria përmbarimore **"STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k.**, njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

-**"Truall", me sipërfaqe 3200 m², ndodhur në Shëngjin, Lezhë, Zona Kadastrale 3126, regjistruar në Regjistrin Hipotekor me nr. 13, datë 31.01.2006, në pronësi të Shoqërisë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a., lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipoteke Nr. 449 Rep., Nr. 211/3 Kol., datë 02.02.2006**. Çmimi fillestar i ankandit është **89,600 Euro;**
-**"Truall" së bashku me depozitë karburanti, me sipërfaqe 4419 m², ndodhur në Shëngjin, Lezhë, Zona Kadastrale 3126, regjistruar në Regjistrin Hipotekor me nr. 14, datë 31.01.2006, në pronësi të Shoqërisë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a., lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipoteke Nr. 448 Rep., Nr. 210/3 Kol., datë 02.02.2006.** Çmimi fillestar i ankandit është **162,036 Euro.**
**Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 06.11.2017.**
**Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambjentet e Shoqërisë Përmbarimore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7. Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com**

BRITISH AMERICAN TOBACCO

**British American Tobacco Albania sh.p.k.**
**Njofton** se duke filluar nga data 06 Nentor 2017, cmimet e reja maksimale të shitjes me pakicë për produktet e saj të duhanit do jenë si vijon:

| Nr | MARKA | Çmimi maksimal/ paketë i shitjes me pakicë |
|---|---|---|
| 1 | Kent Nanotek (Infina) | 300 |
| 2 | Kent Demislims Neo | 280 |
| 3 | Kent Demislims Spektra | 280 |
| 4 | Kent HD Neo | 300 |
| 5 | Kent HD Infina | 300 |
| 6 | Kent HD Neo 10 cigare | 150 |
| 7 | Lucky Strike Red | 230 |
| 8 | Lucky Strike Blue | 230 |
| 9 | Like Strike Blue 10 cigare | 120 |
| 10 | Lucky Strike NFF King Size 6 mg | 230 |
| 11 | Lucky Strike NFF Demislims 6 mg | 220 |
| 12 | Lucky Strike NFF King Size 4 mg | 230 |
| 13 | Lucky Strike NFF Demislims 4 mg | 220 |
| 14 | Rothmans Leggera | 230 |
| 15 | Rothmans of London (Blue) | 200 |
| 16 | Rothmans of London (Sky Blue) | 200 |
| 17 | Rothmans of London (Silver) | 200 |
| 18 | Dunhill FC 7 mg | 320 |
| 19 | Dunhill FC 4 mg | 320 |
| **20** | **Rothmans of London Demislims 6mg (Produkt i ri)** | **200** |
| **21** | **Rothmans of London Demislims 4mg (Produkt i ri)** | **200** |

***Çmimet shprehen në Lek**
Njoftimi i mësipërm bëhet në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr.6, datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar".

**British American Tobacco Albania sh.p.k.**
**Tirane, Rr:"Kavajes", ish Kombinati Ushqimor**
**web: www.bat.com**
**office phone: +355 (0) 42 255084**



Ish-ministri rrëfen nga shtëpia: Familja e stresuar, po mundohem t'u jap forcë

# Tahiri: Nuk pranoj gjyq politik, parlamenti është defaktorizuar

## "Askush nuk mund të më mbyllë karrierën politike"

*Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri hapi dyert e shtëpisë së tij për gazetarin Sokol Balla, në emisionin "Top Story" pas kontrollit të bërë nga policia gjyqësore, pak ditë më parë. I pyetur për akuzat ndaj tij, të ngritura nga Prokuroria dhe si e pritën njerëzit e tij të afërt, Tahiri tha se familja e priti me stres të madh. Ai shtoi se të bësh politikë në Shqipëri ka kosto, megjithatë politika nuk i është neveritur akoma. Ai deklaron se nuk ka imunitet dhe se po hetohet nga Prokuroria si i tillë dhe se është i vetmi deputet që i kanë hyrë në shtëpi prokurorët. Tahiri deklaroi se asnjëherë nuk ka paragjykuar një vendim të gjykatës. Lidhur me përjashtimin nga grupi parlamentar i PS-së, Thairi u shpreh: "Nuk e pashë si gjyq politik përjashtimin nga Partia Socialiste. Edhe sikur një deputet apo drejtues i vetëm në PS e çon nëpër mend që mund të më bëjë gjyqin politik, unë nuk e pranoj në asnjë rast", u shpreh ai. Të njëjtin qëndrim ruan edhe për Parlamentin, për të cilin thotë se është defaktorizuar. "Është komplet jashtë çdolloj pritshmërie të qytetarëve. Nuk e shihja të arsyeshme të humbisja asnjë minutë kohë në atë Parlament, sepse betejën e kam me drejtësinë", tha Tahiri. Ai shmangu komentet për deklaratat e kryeministrit Rama, bërë në "Zonë e Lirë", fundjavën që shkoi. Por, i pyetur nëse këtu e mbyll karrierën politike, ai shprehet: "Karriera politike nuk mbyllet me urdhër të askujt dhe nuk ka të bëjë me asgjë tjetër, përveçse me besimin e njerëzve, nëse njerëzit besojnë tek e vërteta ime. Mua kjo nuk më shqetëson fare dhe nuk jam nga ata që fatin tim e lë në dorë të të tjerëve".*





**Si u ndjeve kur pe oficerët e Policisë Gjyqësore në shtëpi?**

Ndjesi e sikletshme, por jo e paparashikuar për mua, pavarësisht se detyra gjithmonë më ka bërë të shikoja anën e atyre që hynin në shtëpinë e njerëzve. Është procedurë goxha e vështirë. Kam kuptuar ata që janë ndierë disi të dhunuar nga policia dhe u kam dhënë më shumë të drejtë atyre, që në kohën kur më ankoheshin i neglizhoja pak, por në këtë rast është e detyrueshme për të gjithë ata që janë në një situatë siç jam unë.

**Si e ka përjetuar familja?**

Me stres goxha të madh, s'ta përshkruaj dot, por po mundohem unë t'u jap pak forcë, se ndoshta askush nga ata s'ka menduar që të bësh politikë në Shqipëri ka edhe këto kosto. Kjo e ka kthyer politikën deri diku në një instrument, që u është neveritur njerëzve. Ka shkuar përtej limiteve, por mua nuk më është neveritur, sepse mendoj që periudha të tilla për mua, ndoshta shërbejnë që të tjerë pas meje të mos e kalojnë padrejtësisht.

**Pse zgjodhe t'i përfshish, nuk mendove ta lije jashtë familjen, të përballeshe me akuzat e ndoshta edhe me prangat politike, por ta lije familjen tënde jashtë?**

Po hetohem, jam deputeti i vetëm, të cilit policia i ka hyrë në shtëpi për kontroll, edhe pse në Shqipëri ka pasur plot raste ku akuzat kanë qenë shumë më reale. Askush s'e ka parë edhe shtëpinë pjesë të punës së prokurorisë duke hyrë brenda, s'jam fshehur kurrë pas imunitetit dhe s'kam imunitet. As unë, as çdo deputet i Kuvendit s'ka imunitet. Do përballem me çdo kosto dhe pasojë të veprimeve të mia për të nxjerrë të vërtetën.

> “Karriera politike nuk mbyllet me urdhër të askujt, dhe kjo nuk ka të bëjë me asgjë tjetër përveç me besimin e njerëzve, nëse njerëzit besojnë apo nuk besojnë te unë pas procesit të hetimit, kjo ndan nëse ka karrierë apo jo”.
>
> **KARRIERA**

**A ishte gjyq politik i PS?**

Nuk e besoj dhe nuk e pashë asthu. Edhe sikur një deputet apo drejtues i vetëm në PS e çon nëpër mend që mund të më bëjë gjyqin politik, unë nuk e pranoj në asnjë rast. Në Parlament as nuk pres të bëjnë gjyqin tim e as pres prej parlamentit të gjykojë pozitën time, ai Parlament është defaktorizuar dhe është komplet jashtë çdo lloj pritshmërie të qytetarëve. Unë në këto momente s'e shoh të arsyeshme të humbisja një minutë kohë se s'e kam aty betejën. Deri kur të bëhet drejtësi, nuk kam shpresë as të gjej ndonjë gjë nga Parlamenti lidhur me akuzat që më bëhet.

**Defaktorizuar?**

Jo përfaqësues dhe shumë larg pritshmërisë së njerëzve.

**I referohesh të gjithë sallës?**

Asaj që ndodh çdo të enjte atje dhe është për turp.

**A jeni bërë barrë për PS-në? Si e komentoni përjashtimin tuaj nga grupi?**

Në kushtet që jemi, është një qëndrim gati i detyrueshëm për të mos pasur asnjë koment politik. Unë këtë e kam kërkuar vetë nga kryetari i PS. Kam kërkuar të mos kem asnjë mbrojtje dhe asnjë koment, sepse s'ka pse bëhet politikë në këtë histori. Pres që të gjithë ta marrin të vërtetën nga fjala e drejtësisë, jo nga unë. Nuk prisja më shumë nga vendimmarrja e PS-së.

**Çfarë keni diskutuar me Edi Ramën?**

Duhet të ishe në takim që të merrje përgjigje, të mos e prisje nga unë. Nuk ishte një diskutim si poshtë tavoline. Secili ushtroi detyrën e vet dhe përgjegjësinë e vet përballë njëri-tjetrit dhe përballë publikut. Ishte një diskutim i hapur.

**A ishte diskutim me ton?**

Nuk ka ndodhur kjo.

**Te Arjan Çani, Edi Rama përdori një shprehje "Paske bërë diçka që do t'u japë ushqim qenve për një kohë të gjatë", kë ka nënkuptuar me "qenë", media? Kundërshtarët politikë? Habilajt?**

S'dua të komentoj Edi Ramën dhe atë që thotë ai, se s'më takon fare dhe për më tepër ju keni mundësinë ta pyesni. Unë mund të them që më i kujdesshëm në shitjen e makinës, por 'OK', ky është një gabim njerëzor që mua po më kushton, por nëse do e kisha menduar mirë në atë kohë, s'do e bëja. Përtej kësaj i kam shpjeguar kryeministrit tim arsyet pse ka ndodhur e vendimet që kam marrë.

**Si e ndjetë ju këtë?**

S'kam dëshirë të komentoj, sepse deklaratat e çdokujt prej nesh, përfshirë edhe Edi Ramën duhen lexuar në kontekstin e madh që ndodh. Nuk prirem ta gjykoj, pavarësisht se disa gjëra që kam dëgjuar, unë do t'i bëja ndryshe. Megjithatë, nuk shoh ndonjë hata në atë që tha kryeministri. Ca gjëra do t'i kisha thënë ndryshe. Konceptualisht bie dakord me të, por nuk do të doja që të më mbronte siç mbronte Berisha të tijtë.

> **PRECEDENTI**
>
> “Jam deputeti i vetëm të cilit policia i ka hyrë në shtëpi për kontroll edhe pse në Shqipëri ka pasur plot raste ku akuzat kanë qenë shumë më reale. Askush s'e ka parë edhe shtëpinë pjesë të punës së prokurorisë duke hyrë brenda”.

**Ndihet ai i zhgënjyer nga ju?**

S'e kam dëgjuar ndonjëherë nga kryeministri këtë lloj zhgënjimi që flisni ju. A ka ndonjë raport sot mes Edi Ramës dhe Samir Tahirit? Edhe personal...

Kemi pasur një raport, që për shkak të punës ishim të detyruar të komunikonim disa herë në ditë. Normale që ai ka pasur besim tek unë dhe unë ia kam kthyer me besim e luajalitet.

**Çfarëdo që të ndodhë, a është mbyllur karriera juaj politike?**

E di që shumë njerëz e kanë uruar këtë gjë. Karriera politike nuk mbyllet me urdhër të askujt dhe kjo nuk ka të bëjë me asgjë tjetër, përveç me besimin e njerëzve, nëse njerëzit besojnë apo nuk besojnë tek unë pas procesit të hetimit, kjo ndan nëse ka karrierë apo jo. Mua kjo nuk më shqetëson fare dhe nuk jam nga ata që fatin tim e lë në dorë të të tjerëve.

**IMUNITETI**

"Unë nuk kam imunitet dhe jam, të paktën në dijeninë time, deputeti i vetëm që policia e prokuroria i kanë hyrë për kontroll në shtëpi, edhe pse ka pasur raste kur akuzat kanë qenë shumë më reale. Nuk jam fshehur kurrë pas imunitetit dhe nuk kam imunitet. Asnjë deputet nuk ka imunitet. E vetmja gjë që po e konsideroj imunitet është kontrolli i banesës dhe arrestimi me burg", tha Tahiri.

**SURPRIZA**

Ish-ministri i Brendshëm Saimir Tahiri u surprizua dje në ditëlindjen e tij të 38-të nga një grup të rinjsh të FRESSH, të cilët i kanë mbërritur poshtë banesës së tij me tortë dhe fishekzjarrë. Tahiri është parë i buzëqeshur, teksa ka zbritur nga banesa së bashku me djalin e tij për të takuar të rinjtë dhe për të fryrë qirinjtë e tortës.

**ZAGANI**

"Zagani është hetuar nga Prokuroria e Krimeve të Rënda dhe është dënuar, di që ka fituar azil në kurrizin tim. Di që një oficer tjetër, po të njëjtën gjë ka bërë. Është arrestuar për korrupsion dhe shkon atje e ka kërkuar azil prapë në kurrizin. Është në modë të duket sikur një polic ka luftuar një bandë kriminale, që ka pasur për kokë Saimir Tahirin. Le të vijnë që të dy të përballen me mua para drejtësisë", -tha ai.

PERURIMI
VETINGU

## Rama, mesazh komisionerëve: Drejtësi, pa gjykatës e prokurorë të korruptuar

# Organet e vetingut nisin punën, Lu: Ditë shprese për Shqipërinë

## *Vlahutin: Reforma në drejtësi ka startuar*

Valentina Madani

Organet e vetingut nisën dje zyrtarisht punën. Tri komisionet e reformës në drejtësi nisin zyrtarisht punën. Në inaugurimin e godinës ku do të ushtrojnë funksionin Genta Bungo, kreu i Komisionit të Kualifikimit dhe Natasha Mulaj, që drejton Kolegjin e Apelimit e vunë theksin tek angazhimi që duhet për të reformuar sistemin e drejtësisë. Ndërsa dy ambasadorët Lu e Vlahudin e konsideruan këtë ditë si shumë të rëndësishme dhe shpresë për Shqipërinë. Për dy ambasadorët që kanë ndjekur nga afër reformën në drejtësi, Donald Lu dhe Romana Vlahutin, nisja e procesit të vetingut është një ditë e madhe dhe shprese për Shqipërinë. Pas ceremonisë së inaugurimit të godinës së re të vetingut, tek ish-ndërtesa e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, Lu tha se është një ditë shprese. Anë e mbanë botës kemi kaq shumë lajme të këqija dhe sot (dje) është një ditë për shpresë në Shqipëri", deklaroi ambasadori i SHBA-ve në Tiranë. Kurse, ambasadorja e BE-së në Tiranë Romana Vlahutin deklaroi: "Jemi shumë të lumtur, sepse në një farë mënyre reforma ka startuar, po shohim edhe një staf të dedikuar në institucionet e vetingut". Kryeministri Edi Rama iu uroi suksese komisionerëve të vetingut, pas inaugurimit të godinës së re, që do jetë tek ish-godina e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve. Rama shkruan në 'Twitter' se njerëzit e këtij vendi meritojnë një sistem drejtësie pa gjykatës e prokurorë të korruptuar. "Urime, kurajë, suksese komisionerëve të vetingut! Njerëzit e këtij vendi meritojnë një sistem drejtësie pa gjykatës e prokurorë të korruptuar", shprehet z.Rama. Genta Bungo, kreu i Komisionit të Kualifikimit dhe Natasha Mulaj, që drejton Kolegjin e Apelimit e vunë theksin tek angazhimi që duhet për të reformuar sistemin e drejtësisë. Kryetarja e Kolegjit të Apelimi, Natasha Mulaj, u premtoi të gjithë qytetarëve se do të bëhet drejtësi dhe do të marrë fund epoka e të korruptuarve. Nga ish-godina e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, ku u inaugurua godina e vetingut, Mulaj deklaroi se do të fitohet besimi i qytetarëve te drejtësia dhe do të bëhet drejtësi, edhe sikur qiejt të përmbysen. "Për shkak të eksperiencave të hidhura në përballje me drejtësinë e kanë dëmtuar shumë besimin tek institucionet. Është fakt se pa pastruar radhët tona dhe pa konfirmuar para publikut se jemi ndarë nga korrupsioni, do të ishte e pamundur të rifillojmë përmbushjen e një prej betejave tona më madhore, atë të bindjes te publiku se edhe drejtësia shqiptare është e drejtë. Të gjithë kanë pasur të paktën një eksperiencë të hidhur në drejtësi, duke krijuar kështu bindjen se duhet të jesh i pasur për ta pasur atë. Ne jemi këtu për të provuar se shumë shpejt do të bëjmë ndryshimin epokal, që do të jetë shumë i vështirë. Transparenca dhe përçimi i saj te publiku është një dimension ekzistencial i punës sonë. Nëse nuk do arrijmë të rrisim besimin e qytetarëve te drejtësia, ne nuk do të mund të përmbushim misionin tonë. Për këtë kemi nevojë për mbështetje. 'Të bëhet drejtësi, edhe nëse qielli përmbyset'. Ne duhet të bëjmë detyrën tonë në emër të Shqipërisë së drejtë e të ndershme, të bëjmë drejtësi edhe sikur qiejt të përmbysen", deklaroi Mulaj.



Ambasadorët Lu e Vlahutin, dje në nisjen e punës së vetingut

**NATASHA MULAJ**

Kryetarja e Kolegjit të Apelimi, Natasha Mulaj, premtoi se do të bëhet drejtësi dhe do të marrë fund epoka e të korruptuarve. "Të bëhet drejtësi, edhe nëse 'qielli përmbyset'. Ne duhet të bëjmë detyrën tonë në emër të Shqipërisë së drejtë e të ndershme, të bëjmë drejtësi edhe sikur 'qiejt të përmbysen'", -tha Mulaj.





Kryetarja e Kolegjit të Apelimit, Natasha Mulaj, gjatë ceremonisë së djeshme

## Përurohet godina e vetingut

## Përfaqësuesi i ONM: Proces i gjatë dhe me sfida

Përfaqësuesi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, Theo Jacobs, deklaroi dje se procesi i vetingut është një proces i gjatë dhe me sfida. Gjatë përurimit të godinës së vetingut, Theo Jacobs tha se përkushtimi i ONM nuk do të mungojë për të bërë operacionet e nevojshme në drejtësi. "Duke përfshirë edhe punën që do të bëhet e mi dhe unë në të ardhme do të kemi vështirësi në këtë proces të gjatë dhe me sfida. Megjithatë, përkushtimi ynë nuk do të mungojë për të bërë operacionet e nevojshme në sistemin e drejtësisë. Në këtë mëngjes dhe në këtë ndërtesë të bukur do të fillojnë sfidat tona konkrete. Trupa duhet të jetë e përgatitur për një punë të përgjegjshme dhe të rëndësishme. Ky operacion sapo të filloj, do të sqarojë disa pika që do të sjellin drejtësinë në vend. Duhet të jemi të qartë për mundësitë që na jap ONM, duke ndarë eksperiencën e tyre me komisionet e pavarura për të sjellë drejtësinë në Shqipëri", tha z.Theo Jacobs.



Përfaqësuesi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, Theo Jacobs

**RREZIMI**

Gjykata Kushtetuese rrëzoi dje kërkesën e Unionit të Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, të cilët ankimuan 25 nenet e 3 ligjeve të Reformës në Drejtësi, përkatësisht ato që lidhen me statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për organet e gjyqësorit dhe vetingut.

## Xhafaj: Vetingu filloi, fytyrë e re drejtësie, akt historik

Pas ceremonisë së inaugurimit të godinës së re të vetingut tek ish-ndërtesa e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, reagoi edhe ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Në një status në "Twitter", ai shkruan se pas 3 vitesh punë, impenjim e sakrifica mbërritëm këtu. "Vetingu filloi! 3 vjet punë, impenjim e sakrifica për të mbërritur këtu! Faleminderit të gjithë atyre që besuan në këtë akt historik për drejtësinë. Vetingu, për një fytyrë të re drejtësie, force dhe besimin të njerëzve. Të shpresojmë tek ata që e kanë marrë përsipër këtë mision historik. Urime!", shkruan ministri, i cili ka qenë kryetari i Komisionit të Reformës në Drejtësi. Përpos sistemit të drejtësisë, Xhafaj ka deklaruar se do të këtë veting edhe në institucionin që ai drejton për të larguar nga Policia e Shtetit të gjithë të inkriminuarit dhe të korruptuarit.

## Vetingu, përpunohet më shumë se gjysma e formularëve të vetëdeklarimit

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka përpunuar më shumë se gjysmën e 800 formularëve të vetëdeklarimit, që kanë mbërritur në këtë institucion për rivlerësimin e figurës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe subjekteve të tjera. Kryetarja e Komisionit të Sigurisë Kombëtare, Ermonela Felaj pas vizitës së zhvilluar me drejtuesin e këtij institucioni, Dorian Tola, tha se Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka qenë në kohë me afatet e përcaktuara. "Pavarësisht se ligjet që sigurojnë zbatimin e reformës në drejtësi kanë pasur një vonesë në zbatimin e reformës së drejtësisë, sidoqoftë institucioni ka qenë në kohë me afatet, sepse grupi i punës që merret me shqyrtimin e figurës së gjyqtarëve, prokurorëve dhe figurave të tjera të rivlerësimit kalimtar, aty ishte i ngritur. Ndërkohë, kishte përpunuar më shumë se gjysmën e deklarimeve dhe ishte duke respektuar afatin e vendosur", deklaroi zj.Felaj. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar përfaqësohet me një anëtar në komisionin, që bën shqyrtimin e vetëdeklarimeve të gjyqtarëve dhe prokurorëve.




Deputetët "shpërthejnë" ndaj ministrave socialistë

# Rama, deputetëve: Jo marangozë për drejtorë Ndreu: Po penalizohen njerëzit e PS

Deputetët socialistë kanë debatuar dje në lidhje me zbatimin e memorandumit që ata nënshkruan me ministrat pak javë më parë, në nisje të sesionit parlamentar. Në pjesën e mbledhjes së grupit parlamentar që u zhvillua me dyer të mbyllura ishte kryeministri Edi Rama, që është shprehur se nuk ka profesionistë për postet e drejtorëve në shtet. "Po jua them si kryeministër, nuk dua të dëgjoj të hyni mik tek ministrat për të bërë drejtorë apo shefa në administratë marangozë, njerëz që nuk kanë arsimin përkatës dhe as këngëtarë apo instrumentistë në vend të elektricistëve të OSHEE-së", mësohet të jetë shprehur Rama. Por, kreu i qeverisë është larguar më pas nëse diskutimi ka vijuar mes vetë deputetëve. Pjerin Ndreu tha se ministrat nuk përgjigjen dhe hiqen si pronarë firmash. "Ministrat nuk komunikojnë normalisht dhe për çështje të ligjshme", ka thënë Ndreu. "Deri tani nuk po shohim konkretisht të zbatohet sa i takon marrëdhënies minis-tra-deputetë. Kjo është një marrëveshje shumë e mirë, që nuk ka qenë e shkruar ndonjëherë, por nëse nuk zbatohet, s'ka sens që e kemi pranuar të gjithë bashkë. Dua të di si do të zbatohet. Një tjetër problematikë që vërej është ajo me testimin e mësuesve ku kanë marrë pjesë dhe drejtorët e shkollave. Rezulton se testimin e kanë fituar drejtorët e LSI-së dhe PD-së dhe shumë nga tanët janë skualifikuar. Kjo duhet parë, sepse s'ka pse penalizohen njerëzit tanë", u shpreh Ndreu. Deputeti Bujar Çela mësohet të ketë thënë se ministrat duhet të konsultohen me deputetë meqenëse po diskutohet projektbuxheti i ri. Edhe ish-ministrja Mimi Kodheli ka folur për funksionimin e kontratës mes deputetëve dhe ministrave. Ankesa patën edhe deputetët Xhemal Qefalia e Vullnet Sinaj.


Mbledhja e djeshme e grupit parlamentar të PS-së

Kryeministri lajmëron rritje ekonomike mbi 4% vitin e ardhshëm

# Rama: Nis reforma e ujit, afat disamujor për ata që e vjedhin

## "Nuk financojmë Akademinë Sovjetike të Shkencave"

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama njoftoi dje se që vitin e ardhshëm pritet që rritja ekonomike ta kalojë 4%. Në fjalën e tij para deputetëve të grupit parlamentar socialist, në analizë të projektbuxhetit të vitit 2018, kreu i qeverisë lajmëroi fillimin e reformës së ujit të pijshëm. "Do të bëjmë një takim gjatë kësaj jave për të lançuar projektin e reformës së ujit, duke bërë një thirrje publike mirëkuptimi dhe duke dhënë një afat që ata të rregullojnë gjendjen e paligjshmërisë në raport me sistemin. Do të ketë një afat disamujor për të gjithë ata që sot janë në shkelje të Kodit Penal të Shqipërisë në raport me furnizimin me ujë dhe praktikisht vjedhin këtë mall, që njësoj si energjia nuk është një mall pa zot", tha Rama. Aksioni për prerjen e paligjshme të ujit nis në janar 2018. "Ne do fillojmë prerjen masive të lidhjeve të paligjshme të ujit. Po përgatisim në bashkëpunim me MF, MIE, paketën e mbrojtjes sociale për të gjitha familjet në ndihmë ekonomike që të mos ndjejnë një barrë sa i takon tarifës së ujit. Shqipëria sot harxhon 3-fshin e ujit të pijshëm që ka nevojë. Pra, mjafton që uji të shihet si mall, të kursehet kur vjen puna për derdhjet e panevojshme të tij, jo vetëm që ka për të gjithë, por është i aksesueshëm nga pikëpamje financiare". Gjatë fjalës së tij, ai u bëri të ditur deputetëve të zonës fillimin për 45 ditë të Rrugës së Arbrit. "Ministria ka nisur negociatat për termat e negociatës me kompaninë që rezultoi fituese në garë dhe në harkun e 30-45 ditëve kontrata do të finalizohet dhe puna për Rrugën e Arbrit do të fillojë deri në përfundimin e këtij aksi të rëndësishëm. Së bashku me ministrin e Jashtëm kemi çelur diskutimet me qeverinë maqedonase dhe do të kemi pikë në rendin e ditës të mbledhjes së përbashkët mes dy qeverive që do të mbahet në Pogradec, nevojën që nga pala maqedonase të behet lidhja e nevojshme", u shpreh Rama. Duke folur më tej për projektet që ka qeveria për rregullimin e Muzeut Kombëtar apo qendrave spitalore, Rama u shpreh edhe për Akademinë e Shkencave. "Në kushtet e reja, Akademia 'sovjetike' e Shkencave do të duhet të hyjë në një proces reforme që nuk mund të diktohet nga shteti. Paratë e shpenzuara kot për rroga e shpenzime të pajustifikuara, për të tundur flamurin sovjetik mbi çatinë e Akademisë së Shkencave, edhe 27 vjet pas rënies së komunizmit dhe nuk e di sa bëhen vitet që nga largimi i sovjetikëve, që nuk i morën dot nëndetëset me vete dhe lanë këtu mbi det Akademinë e Shkencave, do të shkojnë për kërkimin shkencor në universitet, do të përfshijnë pas 27 vitesh bibliotekat shkencore të universiteteve në rrjetin e shkencës", tha Rama.


Kryeministri Edi Rama

**SPARTAK BRAHO**

Një nga ish-deputetët më të vjetër të Kuvendit, Spartak Braho, është emëruar nga kryeministri Edi Rama si këshilltar i tij për Parlamentin. Emërimi i Brahos në këtë detyrë është bërë pak ditë më parë. Braho ishte renditur i 20-ti në listën e kandidatëve për deputetë të PS-së në Tiranë, larg listës fituese.



## PD-LSI braktisi Komisionin e Sigurisë, Noka: Aksion politik

Partia Demokratike braktisi dje mbledhjen e Komisionit parlamentar të Ekonomisë dhe Financave. Pas debateve me kreun e komisionit, Erion Braçe, për shkak të kanabisit, deputetët e PD Edmond Spaho, Jorida Tabaku, Agron Shehaj, Dhurata Çupi dhe Nadire Meçorapaj kanë lënë mbledhjen. Ndryshe nga Komisioni i Sigurisë, ku PD-LSI ikën njëherazi nga mbledhja, te Komisioni i Ekonomisë qëndruan dy deputetët e LSI, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu. Jashtë dyerve të Kryesisë së Kuvendit, deputeti demokrat, Flamur Noka deklaroi se opozita ka nisur aksionin kundër qeverisë, por nuk dha detaje se çfarë do ndodhë në ditët në vijim. "Nuk mund të ketë normalitet dhe opozita nuk pranon të bëhet fasadë e organizatave kriminale. Opozita do ndërmarrë aksionin e saj politik për të rrëzuar këtë qeveri kriminale. Ne kemi programin tonë, është bërë publike që qëndrimi ynë është i prerë. Me këtë qeveri nuk pranojmë të ecim në normalitet. Në ditët në vijim do bëhet publik aksioni opozitar", tha Noka.



## Vasili: Radarët e Shqipërisë, në duart e narkotrafikantëve

Në mbledhjen e grupit parlamentar, LSI ka dalë me të njëjtin qëndrim lidhur me atë që e quan skandali i radarëve dhe që sipas saj, ka qenë në dorë të narkotrafikantëve. Pas mbledhjes, kryetari i grupit të LSI-së, Petrit Vasili tha: "Në funksion po të kësaj situate, të një barriere të këtij grupi të strukturar kriminalo-qeveritar, pra të kësaj narko-qeverie, është edhe pengesa e krijuar edhe sot në Komisionin e Sigurisë për të zbardhur të vërteta tronditëse, që lidhen me funksionimin e radarëve, ku siç është bërë edhe publike, ka qenë skandaloze që pikërisht këto instrumente në funksion të kontrollit të sigurisë kombëtare të vendit, të një vendi që është tashmë anëtar i NATO-s, ka qenë në përdorim, nën kontroll, në duart e narkotrafikantëve". Vasili tha se edhe projektbuxheti i vitit 2018 është si një tortë e ndarë nga narkotrafikantët. "LSI - tha Vasili - jo vetëm do të vazhdojë të denoncojë lidhjet e qeverisë me krimin, por edhe do të paraqesë alternativa të qarta për të ulur varfërinë dhe papunësinë".

INSTAT: Rriten rastet e raportimit të dhunës në familje në kryeqytet

# Parandalohet krimi në familje, burri dhunë psikologjike ndaj bashkëshortes

## Iu gjet në banesë armë zjarri, në pranga 44-vjeçari

Ina Allkanjari

Një ngjarje e rëndë është parandaluar dje nga policia e Tiranës, ku ka rënë në pranga një 44-vjeçar, i cili ushtronte dhunë ndaj bashkëshortes së tij. Uniformat blu janë njoftuar nëpërmjet një telefonate për një rast konflikti në një banesë në Picarë, Vorë.

Mësohet se shërbimet e Komisariatit të Policisë Vorë janë nisur menjëherë për në vendngjarje, ku kanë konstatuar një konflikt në familje. Forcat policore kanë bërë të mundur parandalimin e përshkallëzimit të këtij konflikti, pasi shtetasi Saimir P., po ushtronte dhunë psikologjike ndaj bashkëshortes së tij, shtetases M. P.. Nga kontrolli i banesës së këtij shtetasi janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale një armë zjarri, automatik model 56, me tre krehër dhe 90 fishekë dhe një armë e ftohtë, thikë me dy tehe. Nga veprimet hetimore të kryera dhe provat materiale të sekuestruara, oficerët e Policisë Gjyqësore kanë bërë arrestimin në flagrancë të shtetasit Saimir P., 44 vjeç, banues në Picar, Vorë. Materialet procedurale iu kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për veprat penale "Dhuna në familje", "Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak" dhe "Mbajtja pa leje e armëve të ftohta". Sakaq, dhuna në familje përbën një fenomen shqetësues dhe gjendet në të gjitha kulturat, duke ndikuar negativisht në integritetin fizik, psikosocial dhe ekonomik të personit ndaj të cilit ushtrohet dhunë.

**TË DHËNA PËR DHUNËN NË FAMILJE**

Më herët instituti i statistikave ka raportuar se rastet e raportimit të dhunës në familje janë në rritje përkatësisht në Tiranë dhe në Durrës. INSTAT ka sqaruar se është e vështirë të matet niveli për përhapjen e dhunës në familje, pasi ky fenomen konsiderohet si çështje familjare. Si rrjedhojë, ndër faktorët që mund të ndikojnë në raportimin e ulët të dhunës në familje, mund të përmenden turpi, frika nga ndëshkimi, normat kulturore dhe stereotipat që ekzistojnë për dhunën në familje. Të dhënat e raportuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë tregojnë se në vitin 2016 duke e krahasuar me 2015 kemi 7,3 % raportime më shumë. Në total, në rang vendi në 2016 numërohen 3.900 raportime të dhunës në familje. Gjithashtu, nga shifrat e pasqyruara vihet re se norma e ndryshimit e numrin e raportimeve të dhunës në familje ka rritje për vitin 2016 krahasuar me 2012, konkretisht rreth 46,5 % më shumë raportime. Shprehur në terma absolut rreth 1.174 denoncime të dhunës më shumë.

**ARRESTIMI**
Forcat policore kanë bërë të mundur parandalimin e përshkallëzimit të konfliktit në familje, duke vënë në pranga shtetasin Saimir P., i cili po ushtronte dhunë psikologjike ndaj bashkëshortes së tij, shtetases M. P..



Foto ilustruese

### Policia e Dibrës: Shtetësja M.K. ka pësuar dëmtime të lehta

## I shpallur në kërkim për dhunë ndaj ish-bashkëshortes, në pranga 40-vjeçari nga Peshkopia

**PESHKOPI** - Një 40-vjeçar është venë në pranga, pasi akuzohet se ushtroi dhunë fizike dhe psikologjike ndaj ish-bashkëshortes së tij. Ngjarja në fjalë ndodhi në qytetin e Peshkopisë. Burime zyrtare nga policia e Dibrës bënë me dije se Durim K. dyshohet se dhunoi shtetasen me inicialet M.K., duke i shkaktuar asaj dëmtime të lehta. I pandehuri është kapur dhe ndaluar nga policia, pasi ishte shpallur



në kërkim për veprën penale "Dhunë në familje". Specialistët për Hetimin e Krimit në Komisariatin e Policisë Dibër realizuan arrestimin i 40-vjeçarit. Ky shtetas ishte shpallur në kërkim më datë 30.09.2017. Nga dhuna fizike ish-bashkëshortja e tij, shtetases M.K., i janë shkaktuar dëmtime të lehta në trup. Gjatë ditës së shtunë nga shërbimet e policisë u bë ekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër. Materialet i kaluan Prokurorisë Rrethit Gjyqësor, Dibër për veprën penale "Dhunë në familje".

**SHKURT**

### Gjenden 15 kallëpe tritoli, ishin fshehur mes shkëmbinjve

**SARANDË** - Plot 15 kallëpe tritoli me peshë 400 gr secili janë sekuestruar dje nga policia e Sarandës. Lënda plasëse u gjet e fshehur në një thes mes disa shkëmbinjve dhe shkurreve në kodrën mbi lagjen "Baba Rexhepi" të këtij qyteti. Tritoli, me peshë totale 6 kg u gjet pas kontrollit të imtësishëm të zonës të kryer nga policia e qytetit bregdetar. Ndërkaq, policia dhe prokuroria po punojnë për dokumentimin e plotë ligjor të këtij rasti, si dhe për identifikimin dhe kapjen e personave që e kanë fshehur tritolin. Mësohet se në këtë lagje janë gjetur edhe më herët sasi tritoli. Konkretisht: Më 9 maj të 2016-ës, në këtë lagje janë gjetur 12.9 kg tritol; më 3 dhjetor të 2015-ës janë gjetur 32 kg tritol dhe më 29 tetor të 2015-ës janë gjetur 400 gr tritol.

### Punimet në parkun "Rinia", gjenden katër kallashnikovë

**ELBASAN** - Katër kallashnikovë janë gjetur dje të groposur pranë parkut "Rinia" në Elbasan. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se ka qenë punëtori i një firme ndërtimi, ai që kishte gjetur 4 thasë, brenda të cilave kishte armë. "Më datë 30.10.2017, në sallën operative ka ardhur një telefonatë se një punëtor i firmës së ndërtimit që kryen punimet tek parku 'Rinia', gjatë punimeve ka konstatuar të groposura, të futura në thasë katër kallashnikovë. Grupi hetimor shkoi menjëherë në vendngjarje, ku bëri sekuestrimin e armëve të zjarrit. Vijon puna për sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorit", thuhej në njoftimin e policisë.


United Nations Development Programme

TENDER ANNOUNCEMENT

**Subject: ITB FOR RECONSTRUCTION OF CRÈCHE IN "DONIKA KASTRIOTI" QUARTER, BERAT MUNICIPALITY**

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the provision of the above mentioned services/works.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline, set in a sealed envelope and with clearly marked **"RECONSTRUCTION OF CRÈCHE IN 'DONIKA KASTRIOTI' QUARTER, BERAT MUNICIPALITY ".**

**For more details please refer to the link below:**

http://procurement-notices.undp.org/view_notice.cfm?notice_id=42054

**Relevant Dates:** All interested companies should provide their offer in the following address, not later than **9 November 2017,** at 14:00 hrs

**Address for Communication and offers' submission:**

**United Nations Development Programme Albania**
**Str. "Skënderbej", Gurten Center, 2nd floor,**
**Tirana, Albania**
**Fax.No: + (355) 4 225 02 86**
**E-mail: procurement.al@undp.org**

United Nations Development Programme

TENDER ANNOUNCEMENT

**Subject: ITB for "CONSTRUCTION OF SEWAGE SYSTEM AT ROMA AREA, QUARTER 30 VJETORI, BERAT MUNICIPALITY"**

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the provision of the above mentioned services/works.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline, set in a sealed envelope and with clearly marked **"CONSTRUCTION OF SEWAGE SYSTEM AT ROMA AREA, QUARTER 30 VJETORI, BERAT MUNICIPALITY"**

**For more details please refer to the link below:**

http://procurement-notices.undp.org/view_notice.cfm?notice_id=42053

**Relevant Dates:** All interested companies should provide their offer in the following address, not later than **6 November 2017,** at 14:00 hrs

**Address for Communication and offers' submission:**

**United Nations Development Programme Albania**
**Str. "Skënderbej", Gurten Center, 2nd floor,**
**Tirana, Albania**
**Fax.No: + (355) 4 225 02 86**
**E-mail: procurement.al@undp.org**

Avokatja Kola: Sipas VKM, transporti duhet të sigurohet nga shteti

# Gjirokastër, nxënësit përshkojnë 18 kilometra për në shkollën më të afërt

## Prindërit: Fëmijët tanë, në rrezik

Voltiza Duro

Këtë vit të ri mësimor, 9 fëmijë nga fshati Fushëbardhë në Gjirokastër duhet të përshkojnë plot 18 kilometra për të shkuar në shkollën më të afërt. Kjo pasi në muajin shtator të këtij viti, shkolla 9 vjeçare "Karafil Bello" ku nxënësit mësonin më parë, u mbyll pasi nuk plotësonte kapacitetin e përcaktuar të nxënësve. Në një prononcim ekskluziv për "Gazeta Shqiptare" prindërit shprehen tejet të shqetësuar në lidhje me këtë situatë. I pyetur nga "GSH", babai i vogëlushit 9 vjeçar, Hektor Mullai tregon se shpenzimet e rrugës nuk mund t'i përballojnë pasi janë të papunë. "Djali im po torturohet që prej fillimit të këtij viti shkollor. Për shkak se shkolla në fshatin Fushëbardhë u mbyll, i duhet të bëjë çdo ditë 18 kilometra për t'u arsimuar në shkollën "Bilal Golemi", pranë Urës së Kardhiqit. Ikën që në orën 7:00 të mëngjesit e kthehet në orën 3:00 të pasdites dhe i duhet mbi 1 orë për të marrë veten e për t'u qetësuar",- tregon babai i fëmijës në klasën e dytë. Ai, gjithashtu, thekson se çdo ditë duhet të paguajë 100 lekë të rinj për të mbuluar shpenzimet e rrugës. "Ka raste që i shoqërojmë deri te dera e shkollës, por shpesh edhe nuk kemi mundësi. Jemi në merak gjithë kohës pasi e kemi djalin kilometra larg e është shumë i vogël për ta përballuar i vetëm gjithë këtë rrugë",- tregon Mullai i shqetësuar. Janë plot 9 fëmijë që për të ndjekur arsimin e detyrueshëm, duhet të udhëtojnë 18 kilometra e shpenzimet për transportin deri tani mbulohen nga vetë familjet. Por në VKM e posaçme për sistemin e arsimit parauniversitar theksohet krejtësisht ndryshe.


Shkolla 9-vjeçare "Karafil Bello"

"Në dispozitat normative për sistemin e arsimit parauniversitar neni 6, pika 5 thotë se për nxënësit e shkollave 9- vjeçare, nëse shkolla është më shumë se 5 kilometra larg, shteti është i detyruar që nxënësit t'i mbajë në konvikt, pra, nëse nuk ka konvikt duhet t'iu sigurojë transportin",-thotë avokate Margarita Kola për "GSH". Respektivisht, 3 vogëlushë janë në shkollën fillore e për ta shqetësimi i prindërve është edhe më i madh. "Sipas ligjit një nxënës i shkollës fillore nuk mund të bëjë më shumë se 5 kilometra rrugë për të shkuar në shkollën më të afërt, kurse fëmija im bën 18 kilometra. Jam shumë në merak pasi djali im është në klasën e parë dhe për moshën që ka është e rrezikshme të bëjë gjithë këtë rrugë vetëm. Gjithashtu, edhe infrastruktura e rrugës për shkak të amortizimit, vende-vende është në gjendje jo të mirë dhe kjo i shkakton tronditje tim biri",- tregon nëna e 7-vjeçarit. Ndërkohë prindërit kërkojnë nga instancat përkatëse që të paktën të vihet në dispozicion një makinë për fëmijët në mënyrë që të jenë më të sigurt si dhe të mbulohen shpenzimet e rrugës. Ndërkaq, Moisi Muho, një prej anëtarëve të Pleqësisë së fshatit Fushbardhë i pyetur nga "GSH", në lidhje më çështjen tregon se në fillim të vitit shkollor 2017-2018 kryesia e fshatit ka bërë një kërkesë pranë DAR-it në Gjirokastër. "Në fillim, që vendosën të mbyllnin shkollën "Karafil Bello", ne, si kryesi e fshatit Fushëbardhë bëmë një ankesë pranë Drejtorisë Arsimore Rajonale të Gjirokastrës që shkolla të vazhdonte të funksiononte. Por për shkak se nuk plotësohej numri i nxënësve e mbyllën. Nuk e di sesi do të shkojë më tej situata",-thotë Muho.

UNHCR
The UN Refugee Agency

**The United Nations High Commissionaire for Refugees (UNHCR) Representation in Albania is looking for a:**

**"SENIOR PROTECTION ASSOCIATE"**

**Terms of Reference for this position can be found on: www.un.org.al at the section of "*Employment and Procurement*".**

**Interested candidates should send the following documents (in English):**

**- Update P11 entry form and**
**- Motivation Letter**

**to, albti@unhcr.org or in the sealed envelope addressed to: UNHCR Albania, Skenderbej Street, Gurten Building, 2nd floor, Tirana, Albania, referring to the External Vacancy Notice: UNHCR/ALB/TIR/17/GS/02, by 14 November 2017, 5:30 p.m. CET.**

### Nikolla: Do të fillojë reforma tërësore

## Rama: Do të ketë 4 drejtori arsimore të shpërndara në 4 rajone në të gjithë vendin

Në vendin tonë tashmë do të ketë vetëm 4 drejtori arsimore të vendosura në 4 rajone. Lajmi është bërë me dije nga kryeministri Edi Rama gjatë një diskutimi mbi zhvillimin profesional të mësuesve ditën e djeshme. Sipas një harte të ndërtuar mbi bazën e zhvillimit ekonomik dhe jo në sensin e ndarjes administrative, drejtoritë do të vendosen në 4 rajone. Sipas kryeministrit, do të ndryshojë edhe roli i zyrave arsimore, duke u bërë kështu nga zyra emërimesh dhe shkarkimesh, në garant të cilësisë në funksion të realizimit të programit. Rama tha se portali i "Mësuesve për Shqipërinë" ka dhënë rezultate të qarta. "Portali do të bëjë të panevojshme ndërhyrjen njerëzore, bazën e të dhënave për pikët e testeve, krediteve, çdo zëvendësim kur dikush del në pension do të bëhet në mënyrë kompjuterike", shtoi më tej kryeministri. Gjatë këtij diskutimi ishte e pranishme edhe ministrja e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Lindita Nikolla, e cila theksoi se do të fillojë një reformë tërësore. Kjo do të bëhet duke rritur nivelin mesatar e duke aplikuar kuotat e mbyllura. Ndërsa për testin që kryen mësuesit, Nikolla e vlerësoi atë të një niveli mesatar. Sipas saj, në universitete janë regjistruar rreth 400 studentë për t'u bërë mësues që tregu i punës nuk i përthith. "Në janar startojmë me programin dhe platformën e re, duke vënë theksin tek universitetet dhe fakultetet e edukimit. Do të akreditojmë ato universitete që kualifikojnë mësues cilësorë", tha ministrja e Arsimit.



Kryeministri Edi Rama gjatë një diskutimi mbi zhvillimin profesional të mësuesve

IN MEMORIAM

"Familja Dani nuk i ka gjetur akoma kockat e tij dhe duam vetëm të dimë ku prehet"

# Amaneti i Riza Danit: Më varrosni pranë vajzës, me shpresë vdes si burrë

## *Historia e deputetit shkodran, pushkatuar më 1946, nipi: Dua vetëm të di ku prehet*



Nga Kujtim Dani*

Riza Dani pat lindur në Shkodër në një familje patriotike. Mbasi mbaroi shkollën "Ruzhdien" në qytet, vazhdoi studimet në Universitetin e Stambollit. Ra shpejt në kontakt me mjediset patriotike shqiptare dhe që në rini iu përkushtua lëvizjes kombëtar përkrah të vëllait Dan Hasani. Njihte 4 gjuhë, gjermanisht, turqisht, italisht e sllavisht dhe në vitet 1908-1912 qe pjesëtar i "Klubit Gjuha Shqiptare" me miqtë e familjes Atë Gjergj Fishta, Gurakuqi e Dom Ndre Mjeda. Ishte nismëtar i grupit të ngritjes së flamurit në Shkodër në fillimet e vitit 1913 dhe drejtonte gazetën politiko-shoqërore "Shkodra". Me nacionalistët e atdhetarë krijoi organizatën politiko-nacionaliste "Krahu Kombëtar", që luajti rol të madh për lëvizjet kombëtare në vend, për stabilizimin e shtetit të ri shqiptar deri në 1924-ën. Me krijimin e Partisë Popullore, Riza Dani aderon në këtë parti me nacionalistë të tjerë, duke synuar krijimin e një Shqipërie etnike, që



Riza Dani

mbronte interesat e borgjezisë së mesme dhe kishte përparësi të përmirësonte gjendjen e fshatarësisë. Riza Dani zgjidhet deputet i Shkodrës në legjislaturat 1921-1924 së bashku me Luigj Gurakuqin, Atë Gjergj Fishta, Dom Ndre Mjeda, Maliq Bushati e tjerë. Në vitin 1924 emërohet prefekt i qarkut të Durrësit. Si opozitar i qeverisë së Zogut dënohet me vdekje e si pasojë emigron për pak kohë në Fjume të Jugosllavisë e pastaj stabilizohet në Grac të Austrisë. Në një ditë të ftohtë dimri i vijnë dy baxhanakët, Sejfi Vllamasi e Xhevat Korca nga Vjena. Ata i propozojnë për atentatin që do të bëjnë kundra mbretit Zog, në shkurt 1931. Rizai përgjigjet se: "Kështu bëjnë guerilasit çetnikë e bolshevikë me vra mbas shpine e sidomos në dhe të huaj. Ne duhet të mblidhemi e të bajmë një program më të mirë se Zogu e ta paraqesim në parlament, e po fituem me vota, e rrëzojmë Zogun e jo me vrasje të turpshme".

**1939**

Riza Dani në vitin 1939 kthehet në Shkodër përgjithmonë dhe organizohet me patriotë e nacionalistë për çlirimin e vendit nga okupacioni huaj. Nuk pranon krijimin e qeverisë antikombëtare e proitaliane të Shefqet Verlacit. Rizai aderoi në Frontin Demokratik Nacionalçlirimtar për çlirimin e vendit nga okupatori e rindërtimin e tij. Mori pjesë në mbledhjen e Tapizës (korrik 1943) ku formohet Komiteti i Shpëtimit Kombëtar, që ka në program çlirimin e Shqipërisë në kufijtë e 1913-ën e të drejtën universale për vetëvendosje. Emërohet kryetar i frontit për qarkun e Shkodrës e më vonë kryetar i komitetit të Shkodrës. Në zgjedhjet e 2 dhjetorit 1946 zgjidhet nga populli i Shkodrës si deputet. Shumë urdhra e veprime nuk i shërbenin ngritjes së shtetit normal. Burgoseshin e pushkatoheshin pa gjyqe ose me një urdhër në copë letre intelektualë, patriotë, klerikë, studentë, tregtarë, pronarë, ushtarakë etj., ndërsa çdo përpjekje për demokraci, pluralizëm politik e opozitë nuk u përkrahej.

**ROBËRIMI I RI**

Riza Dani në situatat e reja që po kalonte vendi po e kuptonte që prej gjakut të derdhur, Shqipëria ishte çliruar nga okupatori i huaj, por mjerisht do të robërohej nga një sistem sllavo-komunist utopik që po aplikohej. Kuptoi se duhej ngritur zëri nga të gjithë në protesta e veprime opozitare. Grupi i deputetëve demokratë Gjergj Kokoshi, Riza Dani, Kol Preka, Sheh Karbunara e tjerë ranë në kontakt me grupet intelektuale e organizatat opozitare të krijuara nga mesi i vitit 1945 në Shkodër e qytete të tjera. Këto do të organizoheshin për të kërkuar në zgjedhjet e ardhshme një sistem demokratik perëndimor që kishte në themel pluralizmin politik, lirinë e individit, lirinë e fjalës e shtypit. Lëvizjet opozitare u zgjeruan e u formatuan në grupime me veprime politike. Uran Butka në librin "Kryengritjet e para kundra komunizmit" shkruan se në një mbledhje më 6 korrik 1946 në Shkodër, Riza Dani foli për nevojën e organizimit të një kryengritjeje të përgjithshme. Në mbledhjen e 9 të asamblesë, Riza Dani pat kundërshtuar projekt-statusin e paraqitur si jo kombëtar e i ngarkuar me frymë ideologjike komuniste. Më 7 mars 1946, pas vërejtjes që bëri Riza Dani, Nako Spiroja pasi kishte marrë udhëzime e urdhra nga eprorët, dis-

➔


MBRETNIJA SHQIPTARE


TIRANE FR TIRANE 75833 72 28 20

BEJM APEL NE NONJENJAT MESHEIRONJERE TE ASAJ GJYKATE TE LARTE DHE LUTEMI PERVLUTESISHT TE PROPOZONI PRESIDIUMIT TE KUVENDIT POPULLOR FALJEN E KUNATIT DHE VELLAJTE TONE SELAHUDIN TOTOS NGA DENIMI NE VDEKJE GENI DY PALE FEMIJE GRA TE SEJA NE JETIM TE PA RRITUR E NENJA PERHTETE E DETERES TONE ESHT SELAHUDINI LUTEMI MESHIRE PER JETIMET TONE = NDERIME MUREVET TOTO ENVERE TOTO VETO CUCI GJYLSO SODOT


ZYRA TELEGRAFOTELEFONIKE QENDRORE TIRANE

TIRANE FR TIRANA 8118 189 17 18/45

NE AKTORET DHE GJITHE PERSONELI I THEATRIT TE SHTETIT TE MBLEDHUR NE NJE KONFERENCE SINDIKALE I DREJTOJME ATIJ TRUP GJYKUES ME ANE TE KETIJ TELEGRAMI DESHIREN QE KONSISTON NE KETE KERKESE KERKOJMI ME ... T I JEPET DNIMI KAPITAL ARMIQVE DHE TRATHETARVE TE POPULLIT E JU PO GJIKONI SOT KETA TE SHITUR ARMIQ PER VDEKJE TE POPULLIT T ONE KANE DASHE TE PERMBYSYN FITORET E MEDHA QE NE GEZOJME SOT NE SAJE TE LUFTES TE GJAKUT DHE TE SAKRIFISAVE TE PANUMERTA SE BAMI PER T IA ARRIJTE KETA KANE DASHE TE KRIJOJNE NJI GJENDJ SI NE GREQI ME NDIHMEN E ANGLO AMERIKANVE KETA KANE DASHE T I LESHOJNE MONARKO FASHISTAVE QE ESE NGA ATDHEU TNE VETEM PER T IA ARRIJTE QE TE DENE NE KRYE TE NJE REGJIMI SHTYPES PLOT BEJLERE AGALLARE DHE TREGTARE SPEKULLATOR TE NJI REGJIMI KUNDRA POPULLIT ZANI IJONE ASHTE ZANI E AKTORVE DHE I PERSONELIT TE THEATRIT TE SHTETIT QE U NDREJT VETEM NE NJI REGJIM



# Lista e torturave (sipas Kastriot Dervishit)

1 Jeleku (tortura më e tmerrshme, njeriu lidhet pas një huri dhe merr pamjen e një qengji që piqet në hell).
2 Kamxhiku dhe druri.
3 Të lënët pa bukë, pa ujë, pa gjumë dhe në këmbë me ditë të tëra.
4 Korrenti elektrik deri sa i binte të fikët.
5 Hedhja në qafë e zinxhirëve me peshë të rëndë.
6 Lidhja me duar nga pas në dritare ose në ndonjë dru varur deri sa t'i priten gishtat.
7 Thyerja e kockave dhe ndukja e mishit me darë (kjo u përdor sidomos pas dënimit me vdekje të Shefqet Bejës dhe kundra tyre).
8 Kripa në gojë.
9 Shpifnin gjoja sikur do të ekzekutoheshin ose do të vareshin dhe u shtihej në ajër ose shpiheshin te litari.
10 Tortura morale në lidhje me familjen: do të burgosim, do të t'i vrasim, bile në Shkodër për të thyer rezistencën e Dulo Kalit shpunë në një dhomë ngjitur me të dy të burgosura vajza dhe dy të burgosur burra dhe ato bënë gjoja sikur ishin vajzat e tij dhe i kishin prurë t'i çnderuar.
11 Futja kokëposhtë në vozë plot me ujë.
12 Një herë Myftar Tarja (hetues-shënim) i futi një Toptanit nevojë në gojë dhe çorape të palara.
13 Djegia e mishit me cigare. Në fund kundra një provokatori të Kukësit i është hedhur alkool në duar ose në leshra.
– Gjellë me kripë e lënia pa ujë.
– Futje në ujë dhe lënie me tesha të lagura në dimër.
– Pakësim i ushqimit gradual për të vdekur brenda 1 ose 2 vjetëve.
– Lënia pa gjumë në këmbë.

← kuton gjatë e përqendrohet vetëm në fjalën e deputetit të Shkodrës, që e quan si pararojë të reaksionit. Por, Dani iu përgjigj se, "kam qenë kundra turkut, kundra Toptanit, kundra rebelëve, kundra Zogut, kundra italianëve para e pas 7 prillit. Kam qëndruar larg çdo reaksioni e interesi privat. Jo për hatrin e Nako Spiros, por pse kështu e ka kërkuar interesi i atdheut.

**PARANDJENJA**

Dr. Pjetër Pepa në librin "Dosja e diktaturës" shkruan se Dani i di pasojat e fjalimit të ashpër, ndaj i thotë nipit të tij se, "dua një njeri që ta dijë se këtë fjalim e kam shkruar me gjakftohtësi dhe kryesisht i ndërgjegjshëm. Me një fjalë, dua të kem një dëshmitar që të dëshmojë në të ardhmen se shprehjet që kam përdor në Parlament, s'kanë qenë të rastit apo se kam qenë i nevrikosur, por sepse jam i ndërgjegjshëm për ato që të them e për atë që do të ngjase". Ai e kishte të qartë se e priste hakmarrja mesjetare sllavo-bolshevike, megjithatë vendosi të bënte çka kishte bindje. Më vonë, diktatori Enver Hoxha, në librin "Kur hidhen themelet" shënon për Riza Danin se, "ishte njeri me influencë në Shkodër, ishte demokrat, liberal, antizogist e antifashist" dhe se "Dani kërkonte të bënte edhe asamblenë tonë një kuvend ligjesh, ku secili të fliste sa t'i donte qejfi, pa asnjë kufizim e të gjitha ç'thonin Riza Dani me shokë të botoheshin në shtyp". Kur kam lindur më 27 korrik 1946 në darkë, Rizaja po kthehej nga falja e Teravisë në Xhami. I dalin para në oborr e i thonë: "Riza efendi, nusja e Xhevatit lindi djalë. Ai i përgjigjet: Nusja me shëndet të mirë, djali me jetë gjatë, e më vjen keq se kanë me hekë keq". Fjalë profetike për familjen Dani. Riza Dani me intelektualët e Shkodrës do të organizojnë një kryengritje të përgjithshme, ku marrin pjesë forca nga Kallmeti, Lezha, Mirdita e Puka, Zadrima e Nënshati, Postriba e Ura Shtrejtë, Dukagjini e Shoshi, Kopliku, Malësia e Madhe e Kelmendi. Në agim të 9 shtatorit sulmohen kazermat e Shkodrës. Në mesin e shtatorit 1946, u arrestuan të gjithë meshkujt e familjes Dani. Nga gjyqet e diktaturës dënohen 3 vetë 26 vjet burg (së bashku) e Rizai pushkatohet dhe sekuestrohen shtëpitë e fabrikat.

**TORTURAT**

Deputeti Riza Dani arrestohet dhe nga 11 tetori i 1946-ës torturohet nga 'hienat' komuniste antinjerëzore deri në 23 dhjetor 1946, dita kur i hiqet "Imuniteti". Ja si e tregon një pjesë të vuajtjeve të deputetëve të Shkodrës, Kol Prela e Riza Dani, bashkëvuajtësi i qelive e burgjeve, Sami Rrepishti: "Kol Prela më tregoi se në nevojtoren 'qeli' pranë ishte Riza Dani, deputeti i Shkodrës, që herë pas here shpërthente me thirrje të nalta e shamje, që shuheshin menjëherë nga rojet e kuqe e shkopi i tyre mbi kurrizin e shtatëdhjetëvjeçarit demokrat".

Më 11 tetor 1946 merret në pyetjeje Riza Dani nga hetuesi i Sigurimit të ushtrisë, Stavri Xhara para majorëve Vaskë Koleci e Zoi Themeli. Kjo ndodh mbasi ai kishte kalue tortura antinjerëzore, që vetëm ai ka ditur t'i përballojë. Mandati i hiqet në 23 dhjetor 1946, pra një deputet me mandat u nënshtrohet hetimeve me metoda sllavo-mesjetare e qëndron me dinjitet e forcë morale lartë, duke kundërshtuar me guxim të pavërtetat. Hetuesia e përcjell me shënimin: "Qëndrimi i tij para hetuesisë ka qenë armiqësor, nuk ka pranuar të firmosë asgjë". Me qëndrim krenar e stoik e me ndjenjë të lartë përgjegjësie, deputeti Riza Dani deklaron: "Jam i ndërgjegjshëm për çka kam thanë e çka kam ba e veprue. Paçi hijen tuaj". Gjyqi u bë me dyer të mbylura, pa avokat. Nuk ka firmosë e nuk ka kërkue falje. Shpifja është argument i atij që s'ka arsye. 31 dhjetori 1947 si një re e zezë paralajmëron se është mbledhur Këshilli i Gjykatës së Lartë Ushtarake, i mbledhur për të gjykuar 19 të pandehurit. Në ato orë të vona të asaj nate të errët, komunikohet vetëm vendimi ogurzi: 7 pushkatim, 6 burgosje përjetë, të tjerët 20 e 15 vjet burgim. E gjithë kjo bëhet mbi bazën e një "Promemorie përcjellëse" që vinte nga hetuesia e mbushur me shpifje.




**AMANETI DHE VARRI**

Dua ta tregoj dëshminë e fundit të jetës së mundimshme e të palodhur në shërbim të lirisë së vërtet, qëllim që i kishte vënë vetes me ndërgjegje dhe realizoi me ndershmëri e dinjitet deputeti Riza Dani. Këto dëshmi konkrete të shkruara nga dora e tij në rripa letre cigareje ia pat dhënë mbesës së vet, zonjës Fetie. "Çështja është tepër serioze, gjyqi me dyer të mbyllura, pa avokat e publik. Prokurori më akuzon si organizator i organizatës së deputetëve, kam marrë pjesë në mbledhjet e saj, kam ba mbledhje me të arratisur. Janë gënjeshtra të turpshme të formulueme me magji të një sistemi mesjetar torturash, sistem që asht aplikue edhe në mue. Sidoqoftë, moralisht jam i fortë e i kam mohuar të gjitha në gjyq. Ç'vendim jep ky, nuk e di. Rizai", shënohet në një letër tjetër. Më pas ka shkruar: "Me shpresë në Zotin do të vdes si burrë. I falem nderit Fetit për kujdesjen e për gjellët që më ka sjellë. Bulen (gruan) amanet nipave. Këto Feti ia jep doktor Omerit. Kopjen e ruan për histori". Një tjetër ditë ka shkruar: "Tashti që po të shkruaj kam vuajtë shumë, 3 ditë pa bukë e ujë, 20 ditë çimento, shtrojë e mbulojë. Feti thuaj doktor Omerit këto që po të shkruaj: Akuzat i kam refuzue të gjitha si shpifje të turpshme. Në rast hallallëku, dua të varrosem pranë Agimes (vajzës)". Deputeti i Shkodrës, Riza Dani, ekzekutohet në 7 shkurt 1948 e bie me të tjerët në një varr të përbashkët. Familja Dani nuk i ka gjetur akoma kockat e tij dhe duam vetëm të dimë ku prehet.

***Nipi i Riza Danit**










**AGIM GJONÇA**

**"RRITJA E PENSIONIT, JOREALE"**

"Ditën e djeshme jam drejtuar pranë postës për të tërhequr pagesën, por edhe për muajin tetor shtesat nuk janë bërë reale. Kam 2 muaj që marr ende pagesën e vjetër, në një kohë që shtesat nuk e dimë se kur do na jepen. Trumbetojnë me të madhe, por asgjë reale. Shteti prej kohësh shkel të drejtat tona", - thotë Gjonça.



**INDRIT LOSI**

**SHPRESOJMË T'I JAPIN SHTESAT**

"Shkova në fillim të muajit shtator të tërhiqja pensionin dhe mora vetëm 11.500 lekë të reja, e nuk pashë shtesën prej 2300 lekësh të vjetra që është bërë. Shpresojmë shumë që të na i japin në nëntor. Por, dua të theksoj faktin se që prej vitit 2010 nuk kemi parë asnjë rritje reale të masës së përfitimit tonë", - tregon Losi.



**MUSA BASHMILLI**

**NUK KAM MARRË ASNJË SHTESË**

"Pas apelit që bëra në 'Gazeta Shqiptare', arrita të mbledh ndihma dhe borxhe dhe të operohem. Tashmë mund të orientohem paksa për të lëvizur. Ndërsa për rritjen e pensionit, shpresoj që t'i marr në nëntor nga data 6 ose 7. Në shtator nuk kam marrë asnjë pagesë shtesë, kështu që ende jemi në pritje", - shprehet Bashmilli.

Sipas udhëzimit, prej datës 1 shtator 2017 kjo kategori përfitonte rritje pagese

# Të verbrit dhe paraplegjikët nuk marrin shtesat e pensionit

## "Kjo është një tallje e hapur për ne"

Voltiza Duro

Edhe pse kanë kaluar dy muaj, ende nuk është vënë në jetë vendimi për rritjen e masës së përfitimit për të gjithë ata që kanë status invalidi para dhe tetraplegjik apo të verbri. Sipas udhëzimeve të firmosura nga ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu, të publikuara në Fletoren Zyrtare, vendimi duhet t'i shtrinte efektet që prej 1 shtatorit të këtij viti. Individët që gëzojnë statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, sipas udhëzimit të datës 3 tetor 2017, do të përfitonin 10.330 lekë të reja në muaj. Ndërkaq, për personat me statusin e të verbrit, masa e përfitimit do të shkonte 11.730 lekë, e po të njëjtën vlerë do të merrte edhe kujdestari i tij, sipas udhëzimit të botuar në Fletoren Zyrtare në 21 shtator të këtij viti. I raportuar edhe një muaj më parë nga "Gazeta Shqiptare", ky problem vazhdon të mbetet po njësoj. Pra, për pagesat e muajit shtator dhe tetor, shtesat e pensionit që paracaktoheshin të hynin në fuqi që prej datës 1.09.2017 ende nuk janë hedhur në llogaritë e kësaj kategorie. Shuma totale e shpërblimit mujor për të verbrit ka qenë po njësoj si më parë, pra 11.500 lekë dhe shtesa prej 230 lekësh ende nuk është bërë reale. Në udhëzim nënvizohet se: "Për përfitimet nga statusi i të verbrit", të ndryshuar, UDHËZOJ: 1. Masa e përfitimit për shkak të verbërisë, e përcaktuar në pikën 4, të vendimit nr. 277, datë 18.6.1997, të Këshillit të Ministrave, bëhet 11.730 (njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë) lekë në muaj. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i të verbrit". I pyetur nga "Gazeta Shqiptare", Shpëtim Memia, drejtues i degës së Shoqatës së të Verbërve në Tropojë, bën me dije për "GSH" se për muajin shtator ende nuk ka marrë asnjë masë përfitimi shtesë, ndërsa shpreson që shtesat të jepen për të dy muajt së bashku në nëntor. "Totali që mora në shtator ishte vetëm 115 mijë lekë të vjetra. Por, edhe sikur të ishte hedhur kjo shtesë, është qesharake. Është një tallje e madhe që po na bëjnë për vetëm 2300 lekë të vjetra. Këtë 'nder' që po na bëjnë, unë nuk e quaj dot shtesë pensioni. Por edhe këto lekë ende s'po i marrim, shpresojmë tani në nëntor", - thotë Memia. Ndërkohë, Agim Gjonça një prej qytetarëve që gëzon statusin e invalidit, tregon se ditën e djeshme është drejtuar pranë postës për të tërhequr pagesën, por edhe për muajin tetor shtesat nuk janë bërë reale. "Kam 2 muaj që marr ende pagesën e vjetër, në një kohë që shtesat nuk e dimë se kur do na jepen. Trumbetojnë me të madhe, por asgjë reale", - thotë Gjonça. Ndërkaq, në udhëzim citohet se: "Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, UDHËZOJ: 1. Masa e përfitimit për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuar në pikën 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 31, datë 20.1.2001, bëhet 10.330 (dhjetë mijë e treqind e tridhjetë) lekë në muaj. 2. Masa e përfitimit për kujdestarin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të përcaktuar në pikën 4, të vendimit nr. 31, datë 20.1.2001, të Këshillit të Ministrave, bëhet 10.850 (dhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë në muaj. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga 1.9.2017". Kategoritë e sipërpërmendura shprehen se që prej vitit 2010 nuk ka pasur më rritje reale të masës së përfitimit nga statusi që gëzojnë, por thjesht indeksim për të ruajtur po atë nivel pagese.



Foto ilustruese


REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: ***"Blerje pajisje kancelarie, letër format A4 dhe bojë/shirita për printera, për nevojat e Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"***.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 8,200,000 Lekë"**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: ***"Blerje pajisje kancelarie, letër format A4 dhe bojë/shirita për printera, për nevojat e Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"***

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 23 Nëntor 2017, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.


**Bushati: Gratë, të fokusuara te zgjidhja, jo te problemi**

## Aktivitet për barazinë gjinore dhe të drejtat e grave, vlerësohen "heroinat e heshtura"

Gjashtë gra "heroina të heshtura" u vlerësuan me mirënjohje të veçantë gjatë përvjetorit të Ditës së Kombeve të Bashkuara në Shqipëri. Aktiviteti që i kushtohej barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave u organizua dje në mjediset e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme në bashkëpunim me zyrën e Kombeve të Bashkuara dhe Ambasadën Suedeze në Shqipëri. Nga një sipërmarrëse që punon në zona rurale tek një ambientaliste që punon për të mbrojtur tokën, nga një viktimë e dhunës tek një avokate e të drejtave të grave, nga një diplomate tek një luftëtare e zjarrtë kundër drogës dhe krimit; këto gra kanë qenë modele të vërteta për t'u ndjekur në komunitetet e tyre. Ministri Bushati nënvizoi faktin se respektimi i të drejtave të grave luan një rol vendimtar, jo thjesht për çështje numrash. "Qeveria shqiptare ka ndërmarrë angazhime ligjore të rëndësishme për të luftuar diskriminimin dhe për të promovuar e bërë realitet barazinë gjinore, pasi përfshirja e tyre nuk është privilegj ndaj një grupi të shoqërisë, sepse gratë dhe vajzat nuk janë një grup i shoqërisë, por gjysma e saj", - tha ministri.

**VLERESIMI**

Nga një sipërmarrëse që punon në zona rurale tek një ambientaliste që punon për të mbrojtur tokën, nga një viktimë e dhunës tek një avokate e të drejtave të grave;këto gra kanë qenë modele të vërteta për t'u ndjekur në komunitetet e tyre.

Egla Xhemali

## Nikolla Gruevski: U regjistruan kërcënime, shantazhe dhe blerje të votave

# Zgjedhjet në Maqedoni, dalin rezultatet në komunat që u fituan nga shqiptarët

## Kryeministri Zaev: VMRO-DPMNE të njohin rezultatin

**MAQEDONI**

Kanë dalë rezultatet e zgjedhjeve lokale që u mbajtën këtë të diel në Maqedoni. LSDM, sipas rezultateve pas dy raundeve të zgjedhjeve lokale, do të udhëheqë në Shkup dhe 56 komuna, BDI në 10, VMRO-DPMNE në pesë, Aleanca për Shqiptarët në tre, Besa, PDSH dhe PDT në nga një komunë, ndërsa kandidatët e propozuar prej grupeve të votuesve, në tri komuna. Përveçse në Shkup, LSDM dhe koalicioni në raundin e parë të zgjedhjeve më 15 tetor fituan në 37 komuna: Qendër, Gjorçë Petrov, Karposh, Aerodrom, Haraçinë, Berovë, Manastir, Bogdanc, Bosillovë, Vallandovë, Vasilevë, Vevçan, Veles, Gjevgjeli, Debarcë, Dellçevë, Demir Hisar, Dojran, Zelenikovë, Konçe, Koçan, Kratovë, Kriva Pallankë, Krivogashtan, Krushevë, Kumanovë, Lozovë, Mavrovë Rostushe, Negotinë, Novosellë, Ohër, Pehçevë, Prilep, Radovish, Resnjë, Shën Nikollë dhe Strumicë. Në raundin e dytë të zgjedhjeve, LSDM fitoi edhe në 19 komuna: Butel, Gazi Babë, Kisella Vodë, Vinicë, Gradsko, Demir Kapi, Jagunovc, Karbinc, Makedonski Brod, Makedonska Kamenicë, Mogillë, Novaci, Probishtip, Rosoman, Nagoriçan i Vjetër, Çashkë, Çeshinovë Obleshevë, Shtip dhe Shuto Orizare. BDI në raundin e parë zgjedhor fitoi mandate për kryetarë komunash në Kërçovë dhe në Pllasnicë, ndërsa në raundin e dytë edhe në Çair, Tetovë, Saraj, Dibër, Dollnen, Likovë, Tearcë dhe Strugë. Aleanca për Shqiptarët fitoi gjithsej tri mandate për kryetarë komunash, të gjitha në raundin e dytë dhe do të drejtojë komunat Bogovinë, Vrapçisht dhe Gostivar, njofton INA. Besa fitoi në Zhelinë, PDSH në Studeniçan, Partia Demokratike e Turqve në Qendrën e Zhupës, ndërsa kandidatët e cilët u propozuan nga një grup votuesish do të udhëheqin komunat Rankovc, Çuçer Sandevë dhe Bërvenicë. VMRO-DPMNE në raundin e parë fituan në Ilinden, Petrovec dhe Sopishte, ndërsa në të dytin në Zërnovc dhe Kavadar. Reagimi i parë për zgjedhjet lokale të së dielës në Maqedoni ka ardhur nga Partia Bashkimi Demokratik për Integrim, e cila shpalli fitoren në komunat kryesore të banuara nga shqiptarët pas balotazhit të zhvilluar këtë fundjavë. Kreu i saj, Ali Ahmeti tha se bindshëm në Strugë, Çair, në Tetovë rikonfirmohet Teuta Ari, ndërsa kandidatët e partisë së tij udhëheqin Dibër, Saraj, Likovë, Kërçovë dhe të tjera. Ndaj tij reagoi ashpër kreu i Aleancës për Shqiptarët, Ziadin Sela, që akuzoi për manipulime të shumta pasi partia e tij po humbet bastionin e saj, Strugën. Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev tha se rezultati i zgjedhjeve lokale tregoi mbështetjen që ka qeveria e tij, duke i bërë thirrje VMRO-DPMNE-së të njohin rezultatin. Por, kreu i opozitës Nikolla Gruevski tha se zgjedhjet shfaqën parregullsi të shumta. "Është shkelur edhe heshtja zgjedhore. Disa persona kanë shpërndarë fletushka dhe policia ka qenë në shërbim të tyre. Janë regjistruar edhe kërcënime, shantazhe dhe blerje e votave". Pjesëmarrja në raundin e dytë llogaritet rreth 52%. Autoritetet thanë se procesi u zhvillua në mënyrë të qetë dhe pa probleme serioze, megjithëse nuk kanë munguar edhe incidentet e vogla.



Rezultatet e zgjedhjeve në Maqedoni

## "Banda e pyjeve", zbulohen bisedat e shqiptarëve pas grabitjeve

ITALI- Janë zbuluar detaje të reja nga hetimi mbi "Bandën e pyjeve" në Itali, të cilët kryenin grabitje të dhunshme në zonën e Xhenovas. Shqiptarët, pjesë e kësaj bande, Spartak Cakoni 25 vjeç dhe Arti Ndreka 37 vjeç janë arrestuar në prill të këtij viti, ndërsa policia italiane ka bërë publike bisedën mes tyre në rrjetin social "Facebook", pas grabitjes së kryer në 14 prill në një banesë në Serra Riko në Xhenova. Në duar mbanin shufra hekuri, ndërsa vetë ishin të maskuar, për të mos u njohur nga viktimat. Ata talleshin me sjelljen e viktimave. "Ishin si qengja. Nuk flisnin. Ishin të terrorizuar nga frika. Bëmë gabim që nuk përdhunuam gruan. Ajo bashkë me të dashurin nuk do kishin kundërshtuar", - ka shkruar në "Facebook" kreu i kësaj bande, Arti Ndeka, raportojnë mediat vendëse. Fatmirësisht, gjithçka ishte një bisedë ëndërrimtare mes dy "skifterëve" shqiptarë. Sipas autoriteteve italiane, shqiptarët nuk ishin vetëm hajdutë profesionistë, por mendonin edhe dhunën. Dy anëtarët e bandës dyshohet se janë autorë të rreth 13 grabitjeve të kryera mes Mignanego, Serra Riko, Bolzaneto e Sampierdarena, zona pyjore në Genova. Për këtë arsye, grupi njihet si "Banda e pyjeve".



Dokumentet duhet të dorëzohen brenda tre muajve për këstin e parë dhe të dytë

# Ish-të përndjekurit, 3000 trashëgimtarët që përfitojnë dëmshpërblim

## Ministria e Financave: Fëmijët dhe nipërit e ish-të dënuarve të plotësojnë dosjet

Ornela Manjani

Ministria e Financave ka publikuar listën e kategorisë jo parësore në radhët e ish-të përndjekurve politikë që mund të trajtohen me dëmshpërblim, por që sipas këtij dikasteri duhet të sjellin dokumentet e nevojshme. Bëhet fjalë për listën e kategorisë jo parësore, për trashëgimtarët, rreth 3000 përfitues, të cilët do të marrin dëmshpërblim, por më parë duhet të plotësojnë dosjen me dokumente. "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë, së bashku me analizën e dokumentacionit për çdo dosje, si për përfituesit e këstit të parë, ashtu edhe për ata të këstit të dytë. Dokumentet për trajtimin me dëmshpërblim pas shqyrtimit të juristit, duhet të dorëzohen brenda tre muajve.

**DOKUMENTET**

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shuma e dëmshpërblimit kthehet mbrapsht në buxhet duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, Emër/Mbiemër, apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një germë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoemos që në të gjitha dokumentet emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në raste se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon edhe rastet e ekzekutimeve pa gjyq. "Në rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq, është i domosdoshëm një vendim fakti gjykate që vërteton vdekjen, plus një certifikatë negative të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzistojnë dokumente të periudhës përkatëse dhe ky fakt vërtetohet nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative", - thuhet në njoftimin që Ministria e Financave bën për të sqaruar trashëgimtarët e ish-të dënuarve që nuk kanë marrë ende dëmshpërblimin.

## TRASHËGIMTARËT PËR KËSTIN E PARË

SHENIM: kur dokumentacioni eshte I rregullt shenohet me V,kur mungon shenohet me X,kur kane autorizuar me prokure shenohet me P.

| NR. DOSJES | EMER | MBIEMER | VKM NR. | EMER | ATESIA | MBIEMER | EMER | ATESIA | MBIEMER | KOPJE TE LETER NJOFTIM | NUMER PERSONAL LLOGARI BANKARE | CERTIFI-KATE VDEKJE | CERTIFI-KATE E TRUNGUT FAMILJAR | DESHMI TRASHGI-MIE | PRO-KURE |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2939 | ZEF | FUSHA | | | | | | | | | | | V | V | |
| | | | | FRAN | ZEF | FUSHA | | | | V | V | | | | V |
| | | | | GEGE | ZEF | FUSHA | | | | V | V | | | | |
| | | | | TOM | ZEF | FUSHA | | | | | | V | V | V | |
| | | | | | | | DRANDE | TOM | DELIJA | V | | | | | P |
| | | | | | | | KATRINE | TOM | METUSHAJ | V | | | | | P |
| | | | | | | | TONIN | TOM | FUSHA | V | | | | | P |
| | | | | | | | VUKSAN | TOM | FUSHA | V | | | | | P |
| 9801 | HAJDAR | XHIKA | | | YMER | | | | | | | V | V | V | |
| | | | | FETAH | HAJDAR | XHIKA | | | | | | | | | |
| | | | | | | | BEDRIJE | FETAH | CULLHAI | X | X | | | | |
| | | | | | | | AJET | FETAH | XHIKA | X | X | | | | |
| | | | | | | | TOMOR | FETAH | XHIKA | X | X | | | | |
| | | | | MURAT | HAJDAR | XHIKA | | | | | | V | V | V | |
| | | | | | | | IDAJET | MURAT | XHIKA | V | V | | | | V |
| | | | | | | | FATUSHE | MURAT | NDREU | V | | | | | P |
| | | | | | | | HAJDAR | MURAT | XHIKA | V | | | | | P |
| | | | | | | | LULJETA | MURAT | XHANI | V | | | | | P |
| | | | | | | | SUZANA | MURAT | HIDRI | V | | | | | P |
| | | | | ZEGJINE | HAJDAR | CERRIKU | | | | | | V | V | V | |
| | | | | | | | FERIT | MERSIN | CERRIKU | V | V | | | | |
| | | | | | | | BEHAR | MERSIN | CERRIKU | V | V | | | | |
| | | | | HATIXHE | HAJDAR | LAMCJA | | | | V | | | | | P |
| | | | | HAJRIJE | HAJDAR | AZIZOLLI | | | | | | V | V | V | |
| | | | | | | | NAFIRETE | PETREF | XHINDOLI | V | V | | | | |
| | | | | | | | SERVET | PETREF | AZIZOLLI | V | V | | | | |
| 8108 | RAMAZAN | HABILI | | | ABAZ | | | | | | | V | V | V | |
| | | | | VATHE | | HABILI | | | | | | V | V | V | |
| | | | | LIZE | RAMAZAN | ELEZI | | | | V | | | | | P |
| | | | | QEOSERE | RAMAZAN | KOLGJINI | | | | V | V | | | | V |
| | | | | RAGIP | RAMAZAN | HABILI | | | | | | V | V | V | |
| | | | | | | | HAMID | RAGIP | HABILI | V | | | | | P |
| | | | | | | | XHEVAT | RAGIP | HABILI | V | | | | | P |
| | | | | | | | SHKELZEN | RAGIP | HABILI | V | | | | | P |
| | | | | | | | RUDINA | RAGIP | ISUFI | V | | | | | P |
| | | | | | | | VALBONA | RAGIP | VOGLI | V | | | | | P |
| | | | | | | | LINDMIRA | RAGIP | BELBA | V | | | | | P |
| | | | | | | | ADRIAN | RAGIP | HABILI | V | | | | | P |
| 17613 | FEZE | ÇEKREZI | | | MURAT | | | | | | | V | V | V | |
| | | | | FETAH | FEZE | ÇEKREZI | | | | X | X | | | | |
| | | | | BUKURI | FEZE | BAHA | | | | V | | | | | X |
| | | | | MURAT | FEZE | ÇEKREZI | | | | V | V | | | | V |
| 20525 | RAMAZAN | KULLOLLI | | | | | | | | | | V | V | V | |
| | | | | IKE | RAMAZAN | TOROMANI | | | | | | V | V | V | |
| | | | | | | | HAMIDE | | KLLOGJRI | V | | | | | P |
| | | | | | | | BAJAME | | MUCA | V | | | | | P |
| | | | | | | | SABIRE | | KOCI | | | V | | | |
| | | | | | | | SHKELQIM | | TOROMANI | V | | | | | P |
| | | | | ZELIHA | RAMAZAN | VELIU | | | | V | V | | | | |
| | | | | SHEGE | RAMAZAN | ELEZI | | | | V | V | | | | |
| | | | | HAMET | RAMAZAN | KULLOLLI | | | | | | V | V | V | |
| | | | | | | | ARBEN | HAMET | KULLOLLI | V | X | | | | |
| | | | | | | | VALJETA | HAMET | SHARKU | V | V | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | MERITA | QAMIL | LICI | V | V | | | | V |

SHENIM: kur dokumentacioni eshte I rregullt shenohet me V,kur mungon shenohet me X,kur kane autorizuar me prokure shenohet me P.

| NR. DOSJES | EMER | MBIEMER | VKM NR. | EMER | ATESIA | MBIEMER | EMER | ATESIA | MBIEMER | KOPJE TE LETER NJOFTIM | NUMER PERSONAL LLOGARI BANKARE | CERTIFI-KATE VDEKJE | CERTIFI-KATE E TRUNGUT FAMILJAR | DESHMI TRASHGI-MIE | PRO-KURE |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 627 | JORGO | LEZO | | | ANDON | | | | | | | V | V | V | |
| | | | | LEONIDHA | ANDON | LEZO | | | | V | V | | | | |
| | | | | LEFTER | ANDON | LEZO | | | | | | V | V | X | |
| | | | | KOSTA | ANDON | LEZO | | | | | | V | V | V | |
| | | | | | | | ANDON | KOSTA | LEZO | V | V | | | | |
| | | | | SPIRO | ANDON | LEZO | | | | | | V | V | V | |
| | | | | | | | KRISTAQ | SPIRO | LEZO | V | | | | | P |
| | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | ELENI | DHIMITER | CACAJ | V | V | | | | V |
| 19738 | MAHMUT | HASI | | | BEQIR | | | | | | | X | X | V | |
| | | | | FAZILE | MAHMUT | SKURA | | | | X | X | | | | |
| | | | | SADIK | MAHMUT | HASI | | | | | | V | X | V | |
| | | | | | | | DONIKA | SADIK | KUKELI | X | X | | | | |
| | | | | | | | PAJTIM | SADIK | HASI | X | X | | | | |
| | | | | | | | BAJDE | SADIK | LOSHA | X | X | | | | |
| | | | | | | | ROMEO | SADIK | HASI | X | X | | | | |
| | | | | | | | GAETANO | SADIK | HASI | X | X | | | | |
| | | | | ALI | MAHMUT | HASI | | | | V | V | | | | |
| | | | | XHEVDET | MAHMUT | HASI | | | | X | X | | | | |
| | | | | NAFIJE | MAHMUT | XHARI | | | | | | | | | |
| | | | | | | | YLLE | | HOXHA | X | X | | | | |
| | | | | | | | DASHURIE | | MANARKOLLI | X | X | | | | |
| | | | | | | | VIKTOR | | XHARI | X | X | | | | |
| | | | | | | | ANTONETA | | XHARI | X | X | | | | |
| | | | | | | | ULVI | | XHARI | X | X | | | | |
| | | | | SHAME | MAHMUT | MANARKOLLI | | | | | | | | | |
| | | | | | | | SULLTANE | | ALDEDJA | X | X | | | | |
| 20919 | JANI | ÇAMI | | | | | | | | | | V | V | V | |
| | | | | KOÇO | JANI | ÇAMI | | | | X | X | | | | |
| | | | | VASIL | JANI | ÇAMI | | | | X | X | | | | |
| | | | | ILIA | JANI | ÇAMI | | | | X | X | | | | |
| | | | | ANTHULLA | JANI | GAÇO | | | | V | V | | | | |
| | | | | DHIMITER | JANI | ÇAMI | | | | V | V | | | | |
| | | | | AFRODHITI | JANI | VOKO | | | | | | V | V | V | |
| | | | | | | | ELI | NIKOLLA | BICUNI | V | V | | | | V |
| | | | | | | | FIGALIA | NIKOLLA | VOKO | V | | | | | P |
| | | | | LLAMBI | JANI | ÇAMI | | | | X | X | | | | |
| | | | | ANASTASIA | JANI | PAPA | | | | X | X | | | | |
| 20290 | SALI | DERVISHI | | | JUSUF | | | | | | | V | V | V | |
| | | | | JUSUF | DALI | DERVISHI | | | | | | V | V | V | |
| | | | | AHMEDIJE | ALI | DERVISHI | | | | | | X | V | X | |
| | | | | SELMAN | JUSUF | DERVISHI | | | | X | X | | | | |
| | | | | BAFTIJE | JUSUF | MARKU | | | | X | X | | | | |
| | | | | LAZAM | JUSUF | DERVISHI | | | | | | V | V | | |
| | | | | | | | DALI | LAZAM | DERVISHI | V | V | | | | |
| | | | | | | | AVNI | LAZAM | DERVISHI | V | V | | | | |
| | | | | NAZIFE | JUSUF | MANDRRI | | | | V | | | | | X |
| | | | | MERJEME | JUSUF | KABA | | | | V | | | | | P |
| | | | | EMRIE | JUSUF | KACANI | | | | V | | | | | P |
| | | | | MUEDIN | JUSUF | DERVISHI | | | | V | V | | | | V |

Lista emërore edhe në Shkodër dhe Malësi e Madhe. Kompensimi fizik e financiar, në rend kronologjik

# Pronat në qarkun Shkodër, dosjet në shqyrtim

## *Emrat e pronarëve, çështjet e të cilëve po trajtohen nga ATP*

Agjencia e Trajtimit të Pronave ka marrë në shqyrtim dosjet në qarkun e Shkodrës, të cilat janë në proces shqyrtimi. Regjistri i dosjeve në shqyrtim pasqyron numrin e dosjes, emrin e subjektit të shpronësuar, kërkuesin, llojin e pasurisë si dhe të dhënat në lidhje me sipërfaqen e njohur, sipërfaqen e kthyer dhe sipërfaqen e kompensuar. Në regjistër janë edhe të dhënat për çdo dosje për vendimet e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe problematika që ka çdo dosje, e cila pasqyron mangësinë në dokumentacion. "Gazeta Shqiptare" po boton sot listën e dosjes së pronave që janë në shqyrtim në qarkun e Shkodrës, ku përfshihet edhe Malësia e Madhe.

Dosjet ndodhen në Agjencinë e Trajtimit të Pronave në proces shqyrtimi do të trajtohen me ligjin e ri. Vendimi do të merret sipas rendit kronologjik të kërkesave edhe kompensimi do të përndahet sipas këtij rendi, me përjashtim të rasteve kur subjekti kërkon të përfitojë nga pagesa e përshpejtuar, ose kërkon të jetë pjesë e tenderit për kompensimin fizik në bazë të pronave që ka vënë në dispozicion ATP-ja. ATP do t'i japë përparësi kompensimit të truallit. Kompensimi për ish-pronarët për tokën truall, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe hartës së vlerës së tokës që është në fuqi, do të kryhet me para. Kufiri i caktuar nga ligji është 50 milionë lekë për çdo vendim të njohur.

### DOSJET NË SHQYRTIM NË QARKUN E SHKODRES

| Rrethi | Emri (Subjekti i shpronesuar) | Emri (Subjekti Kerkues) | Sip e pretenduar, Lloji I pasuris | Zona Kadastrale | Sip. E Njojhur/ Mosnjohje | Sip. E Kthyer | Sip. E Kompensuar | Dosari ku ndodhet dosja | Problematika | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 13151 | 1996 | Vlorë | Elham | Hoxha | | | 1996 | 2616 | | 71,500.00 |
| 13152 | 17.3.1994 | Durres | Palok | Gurashi | | | 1996 | 8515 | 1725 | |
| 13153 | 27.9.1995 | Durres | Lush | Haxhia (Musta) | | | 1996 | 8515 | 448.1 | |
| 13154 | 20.10.1994 | Durres | Ibrahim | Elezi | | | 1996 | 8512 | 12000 | |
| 13155 | 20.11.1994 | Durres | Ali | Elezi | | | 1996 | 8514 | 12000 | |
| 13156 | 1.9.1994 | Durres | Nazar | Kulla | | | 1996 | 8513 | 225 | |
| 13157 | 8.9.1993 | Durres | Zef | Kadare | | | 1996 | 8518 | 500 | |
| 13158 | 10.7.1994 | Durres | Urani | Shani | | | 1996 | 8512 | 890 | |
| 13159 | 6.3.1996 | Durres | Vasil | Korroqa | | | 1996 | 8512 | 146 | |
| 13160 | 22.4.1996 | Lezhë | Bajram | Hasani | Bajram | Hasani | 1996 | 1986 | | |
| 13161 | | TIRANE | HAJRULLA | VORPSI | BASHKIM | VORPSI | 1996 | 8150 | 23 | |
| 13162 | 30.8.1994 | TIRANE | RAMAZAN, IBRAHIM, | ABAZI | RAMAZAN | ABAZI | 1996 | 8160 | 25 | |
| 13163 | 24.3.1994 | TIRANE | YMER, SHABAN | KAÇERI | SHABAN | KAÇERRI | 1996 | 8150 | 26.2 | |
| 13164 | | TIRANE | YMER, SHABAN | KACERI | SHABAN | KAÇERRI | 1996 | 8150 | 38 | |
| 13165 | 30.8.1994 | TIRANE | RAMAZAN | SENA | RAMAZAN | SENA | 1996 | 8150 | 16.5 | |
| 13166 | | TIRANE | SEMIHA | SHYRBA | SEMIHA | SHYRBA | 1996 | 8140, 8180 | 121 | |
| 13167 | 22.8.1994 | TIRANE | REXHEP | SPAHIU | REXHEP | SPAHIU | 1996 | 8150 | 42.2 | |
| 13168 | 22.8.1994 | TIRANE | REXHEP | SPAHIU | REXHEP | SPAHIU | 1996 | 8370 | 303 | |
| 13169 | SKA | TIRANE | HYSEN | TURKU | | | 1996 | 8150 | 150 | |
| 13170 | 30.8.1994 | Shkoder | Luigj | Gjoni | Luigj | Vokrri | 1996 | 1920 | 7000 | |
| 13171 | 13.9.1996 | Shkoder | Osmani | Mlloja | Isa | Mlloja | 1996 | 3652 | | |
| 13172 | 2.2.1994 | Shkoder | Gjeto | Ulaj | Trashegimtaret Ulaj | | 1996 | 2015 1869 | | 20000 |
| 13173 | PA DATE | TIRANE | FEJZULLA | KUCI | KALEM | KUCI | 1996 | 2596 | 1737 | |
| 13174 | 25.3.1994 | TIRANE | INAJET | DELVINA | INAJET | DELVINA | 1996 | 8380 | 170 | |
| 13175 | 24.3.1994 | TIRANE | HYSEN | HENA | HYSEN | HENA | 1996 | 8350 | 170 | |
| 13176 | 31.8.1994 | TIRANE | MEHMET | ÇAMI | RAMAZAN | REXHA | 1996 | 8230 | 230 | |
| 13177 | PA DATE | TIRANE | ABAZ | HOXHA | | | 1996 | 1669 | 2350 | |
| 13178 | 31.1.1996 | DURRES | Hasan | Dedja | | | 1996 | 8621 | 2045 | |
| 13179 | 31.8.1994 | Durres | Qamil,Shyqyri | Qesja | | | 1996 | 2742 | 11170 | |
| 13180 | 28.3.1994 | Durres | Muharrem | Zalla | | | 1996 | 8621 | 1260 | |
| 13181 | 15.12.1994 | Durres | Shaban | Turku | | | 1996 | 8621 | 84 | |
| 13182 | 19.12.1994 | Durres | Haxhi | Berushi | | | 1996 | 8621 | 3860 | |
| 13183 | 19.12.1995 | Korce | Sejdali | Pysqyli | | | 1996 | 1410 | 911 | |
| 13184 | 24.3.1994 | TIRANE | HAMID | TROCI | HASAN | DIBRA | 1996 | 8350 | 90 | |
| 13185 | 30.11.1993 | TIRANE | ATLIJE | ELEZI (ADLIJE) | | | 1996 | 8150 | 680 | |
| 13186 | 6.1.1994 | TIRANE | SKENDER, ASTRIT | KALENJA | SKENDER | KALENJA | 1996 | 8370 | 94.8 | |
| 13187 | 1993 | Vlore | Hasir | Berberi | Arif | Berberi | 1996 | 1464 | 1,794.00 | |
| 13188 | 1994 | Vlore | Namik | Shima | Maksut | Shima | 1996 | 3800 | 1,428.00 | |
| 13189 | | DIBER | EQEREM | LAZRI | SKENDER | LAZRI | 1996 | 2932 | | 1012 |
| 13190 | PA DATE | DIBER | HAQIF | SHEHU | HAKI | SHEHU | 1996 | 2932 | 660 | |
| 13191 | SKA | DIBER | NERULLA | SHEHU | BASRI | SHEHU | 1996 | 2932 | 2710 | |
| 13192 | Viti 1996 | Lezhë | Preng | Prenga | Doda | Rasha | 1996 | 2552 | | 22100 |
| 13193 | | Lezhe | Ndue | Shkurti | Ndue | Shkurti | 1996 | 1304 | 13612 | |
| 13194 | 94-95 | Lezhe | Gjon | Drobi | Gjon | Drobi | 1996 | 3721 | | 4821 |
| 13195 | | TIRANE | HAXHI | ZHUPA | HAXHI | ZHUPA | 1996 | 8160 | 265 | |
| 13196 | 25.1.1994 | TIRANE | KOMUNITETI MYSLYMAN | KOMUNITETI MYSLYMAN | | | 1996 | L. SULEJMAN PASHA | 185.2 | |
| 13197 | 25.1.1994 | TIRANE | KOMUNITETI MYSLYMAN | KOMUNITETI MYSLYMAN | | | 1996 | RR. ALI DEMI | 1049 | |
| 13198 | 4.3.1994 | TIRANE | ÇELO | ZHUPA | ÇELO | ZHUPA | 1996 | 8160 | 48 | |
| 13199 | 1.3.1994 | TIRANE | SALI | MULLALLIU | GEZIM | MULLALLIU | 1996 | 8140 | 604 | |
| 13200 | 13.10.1993 | TIRANE | TAHIR, MUHARREM, | SAUKU | | | 1996 | 8170 | 55026 | |
| 13201 | 2.11.1993 | TIRANE | XHAFERR | SUBASHI | XHAFERR | SUBASHI | 1996 | 8160 | 17478 | |
| 13202 | | TIRANE | OSMAN | MUCA | OSMAN | MUÇA | 1996 | 8150 | 36.3 | |
| 13203 | | TIRANE | SHABAN | VATHI | | | 1996 | 8120, 8130 | 9279 | |
| 13204 | 15.3.1996 | TIRANE | RESHIT | TAGANI | ASLLAN | TAGANI | 1996 | 8160 | 495 | |

| Rrethi | Emri (Subjekti i shpronesuar) | Emri (Subjekti Kerkues) | Sip e pretenduar, Lloji I pasuris | Zona Kadastrale | Sip. E Njojhur/ Mosnjohje | Sip. E Kthyer | Sip. E Kompensuar | Dosari ku ndodhet dosja | Problematika | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 13205 | pa date | TIRANE | ISMAIL | CENOIMERI | ETHEM | CENOIMERI | 1996 | 8330 | 810 | |
| 13206 | 1994 | Vlore | Nezim | baboci | Nezim | Baboci | 1996 | 3746 | 3,184.00 | |
| 13207 | 11.3.1994 | ELBASAN | QAZIM, MUSA | XHEPA | XHEMAL | XHEPA | 1996 | 8521 | 72 | |
| 13208 | 31.8.1994 | KORCE | MIHALLAQ | ZOTO | | | 1996 | 1538 | 980 | |
| 13209 | 11.6.1996 | KORCE | JORGJI | SOTIRI | | | 1996 | 3221 | 180 | |
| 13210 | | Korçe | Mustafa | Mekollari | | | 1996 | 2965 | 3500 | |
| 13211 | 19.6.2007 | Korçe | Mitat | Emin | | | 1996 | 3523 | 1500 | |
| 13212 | 1996 | Korçe | Dhimiter | Xhumetiku | | | 1996 | 3819 | 1066 | |
| 13213 | 1996 | Korçe | Kovivellazeria | Panariti | | | 1996 | 1310 | 4288 | |
| 13214 | 30.8.1994 | Korçe | Istref | Celiku | | | 1996 | 3903 | 2200 | |
| 13215 | 30.8.1994 | Korçe | Miti | Cule | | | 1996 | 3819 | 400 | |
| 13216 | 30.8.1994 | Korçe | Dylber | Kulla | | | 1996 | 1800 | 4700 | |
| 13217 | 30.8.1994 | Korçe | Andrea | Tira | | | 1996 | 3819 | 1050 | |
| 13218 | 6.2.1996 | Korçe | Koli | Morlka | | | 1996 | 1538 | 10035 | |
| 13219 | 31.8.1994 | Korçe | Bilal | Llazi | | | 1996 | 2710 | 1429 | |
| 13220 | 31.8.1994 | Korçe | Hydai | Agolli | | | 1996 | 3716 | 1310 | |
| 13221 | 26.8.1994 | Korçe | Mina | Jorgji | | | 1996 | 3819 | 150 | |
| 13222 | 24.6.2009 | Korce | Muharem | Zacellari | | | 1996 | 2965 | 1500 | |
| 13223 | 19.9.1996 | Shkoder | Tom | Gjeloshi | Angjelina | Gjeloshi | 1996 | 1869 | 5000 | |
| 13224 | 13.9.1996 | Shkoder | Gjelosh | Martiku | Trash Martiku | | 1996 | 2778 | 3160 | |
| 13225 | 13.9.1996 | Shkoder | Arif | Dreshaj | Trash Dreshaj | | 1996 | 1880 | 5000 | |
| 13226 | 11.7.1996 | Shkoder | Zef | Leka | Trash Leka | | 1996 | 1329 | 1000 | |
| 13227 | 31.8.1994 | Shkoder | Zef | Gjoni | Zef | Gjoni | 1996 | 1920 | 7800 | |
| 13228 | 16.9.1996 | Shkoder | Mark | Fusha | Mark | Fusha | 1996 | 2791 | 2960 | |
| 13229 | 24.8.1994 | TIRANE | EMINE,SERVETE | TELITI | RESHAT | TELITI | 1996 | 8551 | | 13200 |
| 13230 | 15.3.1994 | TIRANE | BEDRIJE | PETRELA | BEDRIJE | PETRELA | 1996 | 8340 | 18950 | |
| 13231 | 22.7.1994 | TIRANE | NAILE | SHIJAKU | SHPETIM | TELITI, ETJ | 1996 | 8552 | 1860 | |
| 13232 | | TIRANE | REXH | VORPSI | SHYQYRI | SHKALLA (VORPSI) | 1996 | 8350 | 190 | |
| 13233 | 24.9.1996 | TIRANE | ISUF | MUKA | HYQMET | MUKA | 1996 | 8552 | 8500 | |
| 13234 | 13.8.1996 | TIRANE | ALI | RAMADHI | REMZI | KAPIDANI | 1996 | 8552 | 550 | |
| 13235 | 28.4.1994 | TIRANE | HAMDI | QEFALIA | MYSLYM | QEFALIA | 1996 | 8110 | 6000 | |
| 13236 | 17.3.1994 | TIRANE | ISUF | MUKA | REMZI | MUHA | 1996 | 8551 | 8500 | |
| 13237 | | Fier | Vangjel | Roko | Jorgji | Roko | 1996 | 2772 | 1,400.00 | |
| 13238 | 23.011.1993 | TIRANE | TAHIR | GRORI | HAXHI | GRORI | 1996 | 8160 | 626 | |
| 13239 | 27.11.2006 | TIRANE | HANE | KUKA | ISLAM | KUKA | 1996 | 8160 | 65 | |
| 13240 | | TIRANE | HAJDAR | STAFA | HAJDAR | STAFA | 1996 | 8160 | 94 | |
| 13241 | 12.7.1994 | TIRANE | OSMAN | TETOVA | REXHEP | TETOVA | 1996 | 8180 | 1676 | |
| 13242 | 12.7.1994 | TIRANE | OSMAN | TETOVA | REXHEP | TETOVA | 1996 | 8180 | 1988 | |
| 13243 | 12.7.1994 | TIRANE | OSMAN | TETOVA | REXHEP | TETOVA | 1996 | 8180 | 610 | |
| 13244 | | TIRANE | ISMAIL | BARONI (BAJRAMI) | ISMAIL | BARONI (BAJRAMI) | 1996 | 8160 | 49 | |
| 13245 | | TIRANE | DUHIJE | HASANI | SHEFIK | HASANI | 1996 | 8160 | 372 | |
| 13246 | 31.8.1994 | Korçe | Qiro | Mitre | | | 1996 | 3893 | 1418 | |
| 13247 | PA DATE | TIRANE | HAXH,HALILI | KIKA | KUJTIM, AVENIR | KIKA | 1996 | 3292 | 16000 | |
| 13248 | | TIRANE | ADEM | XHEPA | | | 1996 | 8210 | 3620 | |
| 13249 | 31.8.1994 | TIRANE | RAMAZAN | PETI | RAMAZAN | PETI | 1996 | 8270 | 24000 | |
| 13250 | 24.1.1996 | Berat | Murat e Hajri | Flamuri | | | 1996 | 1729 | 6200 | |
| 13251 | -- | Berat | -- | | | | 1996 | 1729 | | 22600 |
| 13252 | -//- | -//- | Sadik | Dakoli | | | 1996 | 8512 | 13000 | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 13253 | 19.10.1993 | Durres | Vivian, Vasil, Irma | Gjergo | | | 1996 | 8515 | 780 | |
| 13254 | " | Durres | Demir e Sul | Merja | | | 1996 | 8512 | 9381.6 | |
| 13255 | " | Durres | Mehmet e Sul | Merja | | | 1996 | 8512 | 10834 | |
| 13256 | 18.10.1993 | DURRES | PAL | SHTEMBA RI | | | 1996 | 8513 | 40 | |
| 13257 | 6.4.1994 | DURRES | Mantho | Jorgji | | | 1996 | 8512 | 285 | |
| 13258 | _ | DURRES | Mantho | Jorgji | | | 1996 | 8512 | 453 | |
| 13259 | 3.6.1994 | DURRES | SELFO ME VLLEZER | SELFO ME VLLEZER | | | 1996 | 8518 | 260 | |
| 13260 | 10.11.1995 | DURRES | MYSLYM | HALILAJ | | | 1996 | 8518 | 884 | |
| 13261 | 6.9.1993 | DURRES | VELLEZERI T | GJOTA | | | 1996 | 8514 | 11135 | |
| 13262 | 5.4.1994 | Durrës | DHIMITER | LARA | | | 1996 | 8514 | 4250 | |
| 13263 | 15.8.1994 | Durres | Sul | Shehi | | | 1996 | 8515 | | |
| 13264 | 29.9.1993 | ELBASAN | ISAK | DISHANI | DILAVER | DISHANI | 1996 | 8525 | 1600 | |
| 13265 | 29.3.1994 | ELBASAN | ASIL, NIKOLL | THANA | FOTI ASIL | NIKOLLA | 1996 | 8522 | 93 | |
| 13266 | 29.3.1994 | ELBASAN | ASIL, NIKOLL | THANA | FOTI ASIL | NIKOLLA | 1996 | 8524 | 30 | |
| 13267 | 31.8.1994 | ELBASAN | HYSNI | KOTHERJA | LUAN | KOTHERJA | 1996 | 8522 | 330 | |
| 13268 | 31.8.1997 | ELBASAN | HYSEN | MIRAKU | SHAQIR | MUHARREMI | 1996 | 8521 | 160 | |
| 13269 | PA DATE | ELBASAN | ISMAIL | QORRI | ISMAIL | QORRI | 1996 | 8522 | 700 | |
| 13270 | 28.2.1994 | ELBASAN | TASIM | JOLLDASHI | SHPETIM | JOLLDASHI | 1996 | 8521 | 13 | |
| 13271 | 8.4.1994 | ELBASAN | HYSEN, BANU, | PAJENGA | RESHIT | SKILJE | 1996 | 8523 | 459 | |
| 13272 | 26.7.1994 | ELBASAN | RAMAZAN | LULJA | KUJTIM | LULJA | 1996 | 8523 | 2210 | |
| 13273 | 12.9.1996 | ELBASAN | RIZA | ÇELA | QEMAL | ÇELA | 1996 | 8523 | 2220 | |
| 13274 | 7.12.1993 | ELBASAN | NEXHIP | HAXHIADE MI | NEXHIP | HAXHIADE MI | 1996 | 8522 | 4970 | |
| 13275 | 7.12.1993 | ELBASAN | EMIN | HAXHIADE MI | SELAUDIN | HAXHIADE MI | 1996 | 8524 | 392 | |
| 13276 | 15.3.1994 | ELBASAN | HYSEN,MEH M ET | KARAPINJO LLI | MEHMET | KARAPINJ OLLI | 1996 | 8523 | 156 | |
| 13277 | 30.8.1994 | ELBASAN | SADI | HIDA | RUZHDI | HIDA | 1996 | 8525 | 3000 | |
| 13278 | 1993 | Fier | Vangjel e Kozma | Lule | Athina | Lule | 1996 | 8532 | 976.00 | |
| 13279 | | | Tefik | Mustafa | | | 1996 | 3544 | 1420 | |
| 13280 | | | Tefik | Mustafa | | | 1996 | 3544 | 1420 | |
| 13281 | 1995 | KORCE | ELMAS | BILEDHI | | | 1996 | 3768 | 1090 | |
| 13282 | 1996 | Korçe | Xhevit e Hamdi | Spaho | | | 1996 | 3025 | 1103 | |
| 13283 | 29.3.1994 | TIRANE | SABRIE, etj | VRAPI, etj | SABRIJE | VRAPI | 1996 | 8350 | 65 | |
| 13284 | 29.7.1994 | TIRANE | ISUF | BROJKA | ISUF | BROJKA | 1996 | 8150 | 172.5 | |
| 13285 | PA DATE | TIRANE | YMER | BEQIRI | BUJAR | BULKU | 1996 | 2679 | 4137 | |
| 13286 | 11.4.1994 | TIRANE | VESIME | FRASHERI | HYBREF, MEHMET | FRASHERI | 1996 | 2066 | 201244 | |
| 13287 | 24.11.1993 | TIRANE | SPIRO | DISHA | KATINA | DISHO | 1996 | 8360 | 83 | |
| 13288 | 18.1.1994 | TIRANE | REXHEP | KAIMI | REXHEP | KAIMI | 1996 | 8150 | 155 | |
| 13289 | 19.9.1996 | TIRANE | VESIME | FRASHERI | VESIME | FRASHERI | 1996 | 2066 | 201244 | |
| 13290 | | TIRANE | BEGLIE | META | BEGLIE | META | 1996 | 2776 | 900 | |
| 13291 | | TIRANE | SHEH | PAZARI | | | 1996 | 8360 | 155 | |
| 13292 | 26.9.1995 | TIRANE | SULEJMAN | DURAKU | SULEJMA N | DURAKU | 1996 | 2951 | 11200 | |
| 13293 | 11.10.1993 | TIRANE | ISMAIL | MANCAKU | ISMAIL | MANCAKU | 1996 | 2776 | 1920 | |
| 13294 | 31.8.1994 | TIRANE | MYFTAR | HASA | | | 1996 | 8180 | 369 | |
| 13295 | 1996 | TIRANE | HASAN | DUKA | | | 1996 | 2704 | 6745 | |
| 13296 | | Berat | | | | | 1996 | 8502 | 66 | |
| 13297 | 1996 | Korçe | Zyhdi | Backa | | | 1996 | 1627 | 235 | |
| 13298 | | Lezhë | Llesh | Mikeli | Frrok | Gjikola | 1996 | 3123 | | 13980 |
| 13299 | | Lezhe | Nikolle ; Preng | Frroku | Nikolle | Ndoci | 1996 | 2016 | 651 | |
| 13300 | PA DATE | TIRANE | MUHEDIN | LLAGAMI | TRASHEGI MTARET | TRASHEGI MTARET | 1996 | 8150 | 72.6 | |
| 13301 | 16.2.1994 | TIRANE | SULEJMAN | BYLYKU | | | 1996 | 8180 | 15440 | |
| 13302 | 6.4.1994 | Durres | Llambi | Boshku | | | 1996 | 8513 | 107.2 | |
| 13303 | 24.2.1993 | Durres | Hasan | Tobli | | | 1996 | 8512 | 92 | |
| 13304 | " | Durres | Mark | Vlashi | | | 1996 | 8515 | 1180 | |
| 13305 | 5.4.1994 | DURRES | EMIN | EMIRI (GOSHI) | | | 1996 | 8518 | 551.25 | |
| 13306 | 9.5.1994 | Durres | Hamdi | Basha | | | 1996 | 8513 | 804 | |
| 13307 | 26.10.1993 | ELBASAN | TAFIL | KUSHI | HAJRIE, HEKURAN | KUSHI | 1996 | 2531 | 1500 | |
| 13308 | 29.3.1994 | ELBASAN | DILAVER | DOCI | MAHMUT | DOCI | 1996 | 3869 | 2410 | |
| 13309 | 22.3.1994 | ELBASAN | RAMAZAN | KURTI | XHELAL | KURTI | 1996 | 1517 | 5409 | |
| 13310 | | KORÇË | | | | | 1996 | 8581 | 1539 | |
| 13311 | 11.11.1994 | KORÇË | Mihal Filip | | | | 1996 | 8582 | 350 | |
| 13312 | 1994 | KORÇË | Vëllezërit | Manushi | | | 1996 | 8582 | 350 | |
| 13313 | | KORÇË | Tasik | Çomo | | | 1996 | 8581 | 764 | |
| 13314 | | KORÇË | Faik | Berberi | | | 1996 | 8582 | 1436 | |
| 13315 | 1994 | KORÇË | Stavri | Vesho | | | 1996 | 8581, 8582 | 36 | |
| 13316 | 16.11.1993 | KORÇË | Naum | Çomo | | | 1996 | 8581 | 801 | |
| 13317 | 1994 | KORÇË | Filip | Manushi | | | 1996 | 8581, 8582 | 350 | |
| 13318 | 30.8.1996 | Korce | Refat | Ago | | | 1996 | 1202 | 780 | |
| 13319 | | | | | | | 1996 | 1955 | 736 | |
| 13320 | | | | | | | 1996 | 1594 | 6385 | |
| 13321 | 19.7.1996 | Korce | Llazo | Miçi | | | 1996 | 2430 | 340 | |
| 13322 | | KORCE | | | | | 1996 | 8581, 8582 | 421 | |
| 13323 | 1996 | Korçe | Jovan | Janaqi | | | 1996 | 1955 | 678 | |
| 13324 | 25.6.2008 | Korce | Sandri | | | | 1996 | | | 133 |
| 13325 | 4.1.1996 | Shkoder | Tom | Leci(Hila) | Trashegim taret Leci | | 1996 | 2778 | | 46600 |
| 13326 | 12.1.1996 | Shkoder | Frrok ; Mara | Caka | Trashegim taret Caka | | 1996 | 1575 | | 7000 |
| 13327 | 18.1.1996 | Shkoder | Haxhi | Bushati | Trashegim taret | | 1996 | 1329 | | 12000 |
| 13328 | 18.1.1996 | Shkoder | Gjyste | Shahini | Trashegim taret | | 1996 | 1105 | | 1500 |
| 13329 | 2.2.1996 | Shkoder | Ramo | Ibro | Trashegim taret Ibro | | 1996 | 3428 | | 1714 |
| 13330 | 29.2.1996 | Shkoder | Ded | Palaj | Trashegim taret Palaj | | 1996 | 1920 | | 6100 |
| 13331 | 1.3.1996 | Shkoder | Zef | Pjetri | Trashegim taret Pjetri | | 1996 | 1100 | | 7200 |
| 13332 | 23.1.1995 | Shkoder | Reshit | Troshani | Trashegim taret | | 1996 | 2644 | | 51500 |
| 13333 | 1.3.1996 | Shkoder | Elez | Mustafa | Trashegim taret | | 1996 | 2236 | | 5000 |
| 13334 | 25.1.1994 | TIRANE | KOMUNITETI MYSLYMAN | KOMUNITE TI MYSLYMA N | | | 1996 | RR.SHYQYRI ISHMI | 1175 | |
| 13335 | | TIRANE | REUF | MYFTIU | ILJAZ | MYFTIU | 1996 | 8551 | 716 | |
| 13336 | 1994 | Vlore | Josif,Tol | Kedhi | | | 1996 | | 11,787.00 | |
| 13337 | 1993 | Vlore | Muhamet | Selimaj | | | 1996 | 8601 | 192.00 | |
| 13338 | 1996 | Vlore | Thodhori | Karanxha | Thodhori | Karanxha | 1996 | 8601 | 185.00 | |
| 13339 | 1994 | vlorë | Mihal | Papingji | Strathi | Papingji | 1996 | 8601 | 9,375.00 | |
| 13340 | 1994 | Vlorë | Xhaferr | Taushani | | | 1996 | 8601 | 338.00 | |
| 13341 | 1996 | Vlorë | Vezo | Agalliu | Neptone | Shtylla | 1996 | 8601 | 10,000.00 | |
| 13342 | 1995 | ELBASAN | GJOKE | PASKO | TEFTA | SHAPATI | 1996 | 2924 | | 153900 |
| 13343 | 1996 | ELBASAN | ADEM | LALA | ADEM | LALA | 1996 | 2433 | | 13020 |
| 13344 | 27.6.1996 | ELBASAN | SULEJMAN | CELA | QAMILE | KAMPULA (CELA) | 1996 | 3468 | | 45000 |
| 13345 | 10.6.1996 | ELBASAN | HASAN | ALUSHI | SEIT | ALUSHI | 1996 | 3521 | | 20524 |
| 13346 | 1993 | Gjirokaster | Dalan | Kore | Bajram | Kore | 1996 | 8543 | 5750 | |
| 13347 | 1994 | Gjirokaster | Isuf | Nanxa | Qamil | Nanxa | 1996 | 8541 | 1020 | |
| 13348 | 1996 | Gjirokaster | Mertir | Petro | | | 1996 | 8541 | 40 | |
| 13349 | 1996 | Gjirokaster | Shefqet | Bushi | Nuredin | Bushi | 1996 | 8541 | 1268 | |
| 13350 | 194 | Gjirokaster | Naqo Thuapi, | Harilla | Petro | Harilla | 1996 | 8541 | 942 | |
| 13351 | 26.9.1996 | Gjirokaster | Familja | Topulli | Nuri | Topulli | 1996 | 8541 | 115 | |
| 13352 | | Gjirokaster | Dalan | Kore | Barjam | Kore | 1996 | 8542 | 5750 | |
| 13353 | | Gjirokaster | Jani | Harailla | Peto | Harilla | 1996 | 2027 | | |
| 13354 | 1994 | Gjirokaster | | | Raship | Hashorva | 1996 | 8541 | 1560 | |
| 13355 | 2002 | Gjirokaster | | | Avni | Mezini | 1996 | | 2088 | |
| 13356 | viti 1996 | Kukes | Niman | Dushaj | Niman | Lushaj | 1996 | 3649 | 11310 | |
| 13357 | 16.2.2001 | Shkoder | Teofik | Kallogjeri | Trashegim taret | | 1996 | 8591 | 766 | |
| 13358 | 3.8.1994 | TIRANE | PANDI | BINGA | VASIL | BINKA | 1996 | 8150 | 28.8 | |
| 13359 | 28.9.1993 | TIRANE | SELMAN, ISMAIL | BASHA | SELMAN, ISMAIL | BASHA | 1996 | 1605 | 9418 | |
| 13360 | 22.2.1994 | TIRANE | DIDIN | RRAPUSHI | DIDIN | RRAPUSHI | 1996 | 8160 | 88 | |
| 13361 | 22.2.1994 | TIRANE | DIDIN | RRAPUSHI | DIDIN | RRAPUSHI | 1996 | 8160 | 150 | |
| 13362 | 14.7.1994 | TIRANE | SADIK | FREGJA | SADIK | FREGJA | 1996 | 3426 | 920 | |
| 13363 | | TIRANE | SAMIJE | TOPTANI | SAMIJE | TOPTANI | 1996 | 2704 | 58000 | |
| 13364 | PA DATE | TIRANE | SOFIJE, ZEJNEPE | ALLA | | | 1996 | 8150 | 214 | |
| 13365 | 9.9.2008 | Berat | Kadri | Luzaj | | | 1996 | 8501 | | 177900 |
| 13366 | 23.102008 | Berat | Thanas e Vasili | Pushi | | | 1996 | 2381 | | 45500 |
| 13367 | 27.12.2008 | Berat | Aleko | Aleksi | | | 1996 | 3813, 3814 | | 58000 |
| 13368 | | Durres | Hasan | Farruku | | | 1996 | 2590 | 4000 | |
| 13369 | 19.9.1994 | ELBASAN | HYSEN E KADRI | TABAKU | | | 1996 | | 600 | |
| 13370 | | Fier | Avdyl | Lushakaj | Ymer | Lushakaj | 96 | 1351 | 10,100.00 | |
| 13371 | | Fier | Jashar | Zeqo | Zeqo | Zeqo | 96 | 3143 | 11,800.00 | |
| 13372 | | Fier | Avdyl | Toska | Pelivan | Toska | 96 | 3143 | 10,000.00 | |
| 13373 | 1994 | Fier | Halim | Mucaj | Yzedin | Mucaj | 96 | 1811 | 2,800.00 | |
| 13374 | 1994 | Fier | Qani dhe Iljaz | Këmbora | Zaim | Këmbora | 1996 | 3752 | 14,600.00 | |
| 13375 | 23.8.1994 | Fier | Qemal | Hoxha | | | 96 | 2497 | 7,500.00 | |
| 13376 | 17.12.1993 | Fier | Hamit | Toro | Pëllumb | Toro | 96 | 3196 | 500.00 | |
| 13377 | 1994 | Fier | Veiz | Hatillari | Yzedin | Hatillari | 96 | 3196 | | 9,300 |
| 13378 | 31.8.1994 | Fier | Refit | | Servet | Cami | 1996 | 3196 | 11,020 | |
| 13379 | | Fier | Tahir | Sinani | Nefail | Sinani | 1996 | 3031 | | 35,000 |
| 13380 | | Fier | Jovan | Moçi | Koci | Moçi | 1996 | 2288 | | 74,000 |
| 13381 | | Fier | Tafil | Veliu | | | 96 | 3250 | | 33,500 |
| 13382 | | Fier | Mezini | Hanaj | Estref | Hanaj | 96 | 1928 | | 55,000 |
| 13383 | | Fier | Andrea | Moçi | | | 96 | 2288 | | 90,000 |
| 13384 | | Fier | Zeqir | Tafa | Ali | Tafa | 96 | 3196 | | 67,200 |
| 13385 | | Fier | Kamber | Kapo | Bashkim | Kapo | 96 | 3196 | | 55,700 |
| 13386 | | Fier | Hair | Demiraj | Riza | Demiraj | 1996 | 2374 | 10,000 | |
| 13387 | 1996 | Korçë | Hekuran | Shtylla | | | 1996 | 2503 | 2000 | |
| 13388 | 1996 | Kukes | Ismail | Kastrati | Ismail | Kastrati | 1996 | 3037 | | 4813 |
| 13389 | Viti 1996 | Lezhë | Zef | Prençi | Zef | Prençi | 1996 | 1673 | | |

Opinioni i Ditës

# Berlin, 'Dream Liner' Një kullë në pyll

Nga Monika STAFA

*(Vijon nga faqja e parë)*



... për të promovuar Berlinin si një metropol me përmasa botërore. Të tilla panaire apo ekspozita,- shpjegonin ata gjatë dëgjesës së tyre para këshillit perandorak,- ishin mbajtur në Paris, Londër, Vjenë apo dhe në Filadelfia. Por, megjithatë pasi artistët më të famshëm të Berlinit mbaruan diskutimin, Kaiser Wilhelmi II-të, të cilit i ishte dërguar ky propozim fillimisht disa muaj më parë, - shkruan David C. Large në librin e tij "Berlin",- nuk e pranoi atë me arsyetimin se, Berlini nuk ishte ende gati për të nisur këtë betejë të re promovuese cilësisht. Sipas tij, Berlini mbetej ende një qytet jo plotësisht i transformuar në shijet e tij për të mirëpritur një panair kaq të madh.

Lavdia e Parisit ende ia grabit berlinezëve gjumin e natës. Berlini është një qytet i madh vërtet pse jo,-shtoi ai gjatë pritjes me artistët. Një qytet botëror, po të doni ta quajmë edhe kështu,- pat theksuar ai,-e si rrjedhojë mund dhe duhet të mirëpresë një ekspoze botërore. E mirëkuptoj pasionin tuaj të merituar dhe e mbështes si ide, dukshme e lehtë pse ajo qëndron... është kaq tërheqëse kur sheh restorantet e Berlinit, teatrot dhe shfaqjet variete nëpër rrugë e tij ngado. Sikush do të përfitonte prej tij vërtet, kini të drejtë të ëndërroni. Por, -vazhdoi më tej fjalën e tij kaizeri,-Berlini nuk është Parisi. Metropoli francez mbetet ende shtëpia më e madhe e botës; aty atraksioni është shumë më tepër origjinal për çdo panair/ ekspozitë që hapet dhe mbyllet aty për aty. Ndërsa në Berlin, tani për tani nuk ka asgjë që të mund të magjepsë një të huaj, përveç disa muzeve, kështjellave dhe ushtarëve nëpër të.

Pas gjashtë ditësh, me librin e kuq të guidës ndër duar, të botuesit të famshëm të asaj kohe Baedeker, perandori gjerman dukej se kish lexuar çdo gjë me kujdes mes atyre rreshtave. Ndihej i çliruar, sepse megjithatë ai e kish kryer detyrën e tij. Një berlinez i zakonshëm nuk mund t'i kuptojë këto gjëra qartësisht, kish thënë ai, duke drejtuar gishtin drejt librit të kuq të guidave të qytetit. Dhe jam plotësisht i sigurt se do të mërzitej shumë nëse dikush do t'i fliste për to në detaje. E vërteta është se kjo paskësh qenë dhe pengesa kryesore që panairi me përmasa ndërkombëtare, i propozuar prej figurave më të njohura berlineze nuk u mbajt atëkohë. I privuar prej bekimit perandorak për të çelur një ekspozitë të këtij dimensioni, Berlini megjithatë përjetoi një tjetër ngjarje katër vjet më vonë. Në vitin 1896 një Ekspozitë Industriale në rang kombëtar u çel në një prej territoreve të tij,-shkruan më tej D. C. Large në "Berlin". Ngjarja mund të mos kishte firmën e një panairi ndërkombëtar, por kudo prej ideatorëve të saj ndihej përpjekja për ta kompensuar këtë gjë në përmasat dhe shkëlqimin që ajo ofroi. E projektuar të vendosej në parkun më të ri të Berlinit, të quajtur Treptower Park, në pjesën lindore të qytetit, ajo u paraqit si ekspozita më e madhe e mbajtur ndonjëherë në të gjithë botën. Sipërfaqja në të cilën kjo ekspoze u projektua ishte rreth 900,000 metra katrorë. Sallat dhe korridoret e saj, të ndërtuara me një stil të paimagjinueshëm arritën të ekspozonin progresin e frikshëm teknologjik të Gjermanisë perandorake. Panairi Industrial i Berlinit i vitit 1896 mund të ketë qenë vërtet modeli më tipik i kërkesave wilhelmiane, por magjia industriale e shfaqur aty ishte origjinale dhe e pasur me plot simbole, të cilat tregonin se si kryeqyteti gjerman ishte kthyer tashmë në një lider botëror në teknologjinë e avancuar dhe inxhinierinë mekanike. Dhe kjo ekspozitë nuk do të ishte e fundit në këtë fushë, në art apo dhe të tjera dimensione që bota njerëzore zhvilloi që atëherë. Qindra e mijëra ekspozita të hapura pasuan njëra - tjetrën deri në ditët e sotme, të cilat nuk kanë aspak qëllim të arrijnë në ndonjë përfundim, por vetëm të risjellin në vëmendje historinë e Gjermanisë me larushmërinë dhe kundërshtitë e veta. Dua të ndërtoj kështjella dhe kulla të larta,-iu drejtua me pasion të artë mbreti i ri i Bavarisë, Ludwigu i II-të, perandoreshës së Austrisë, Elisabeth, ose ndryshe Sisit. Dua ta mbush vendin tim me to e brenda tyre të luhet muzikë e të performohet art që shpirti njerëzor të mund të jetojë ca shkëndija hyjnore edhe për së gjalli- pat shtuar ai gjatë bisedës me të. Nuk mundesh dot Ludwig i bukur,-iu përgjigj kushërira e tij bavareze,- me to nuk mund ta ushqesh popullin tënd të uritur. Por Ludwigu ndoqi ëndrrën e tij dhe ndërtoi plot kështjella e kulla, të cilat sot demonstrojnë shpirtin e epërm të mbretit 'mjelmë' dhe pasionin e çmendur që ai pati për muzikën e Vagnerit. E si ai, vite më vonë, një racë e tërë mbretërish dhe mbretëreshash do të mbushnin tokën gjermane me ndërtime të stilit kryesisht barok e që bashkë me to u bënë dhe nismëtarët e thekur të dhjetëra ekspozitave tashmë jo vetëm kombëtare.

Nga njëra dhomë në tjetrën, mes kallinjve të grurit që sjellin në kujtesë fizionominë agrare të vendit dhe bazën e tij ekonomike, aty në ato korridore e hollet gjigande të ekspozitave të panumërta që çelen çdo vit në Berlin, vizitori përshkon rrugën historike nga marka e vjetër deri te monarkia e Hohenzollernit përmes portreteve të sovranëve dhe vulave perandorake, hartave krahinore dhe skicave të betejave historike, objekteve të përditshme dhe simboleve të pushtetit, dokumenteve të autonomisë së vjetër së shtresave shoqërore dhe gurëve të kalldrëmit berlinez, me të cilët revolucionarët ngritën barrikadat në vitin 1848, duke e detyruar monarkinë që t'u drejtohej me një deklaratë hipokrite, e cila niste me fjalët "Berlinezët e mi të dashur".

Kjo dëshirë për ta paraqitur veten si në kornizë bashkon pezullinë e akuariumit, në të cilin gjërat duket sikur i nënshtrohen një dekompozimi shumë të ngadalshëm, gati-gati të përjetshëm, me kaosin e një fushe beteje, por të një beteje ama mes objekteve të vlefshme dhe atyre të kota. Është koha kur prusianizmi do të shndërrohej në simbolin e nostalgjisë së një jete me kuptim dhe me stil përkundrejt babelit bashkëkohor të një jete të shformuar dhe absurde të lënë më në fund pas.

Quhet Grunewaldturm. Është një kullë, e kthyer në një monument historik që shtrihet diku në anën perëndimore të pyllit me të njëjtin emër, në Berlinin jugperëndimor. Ndërtimi i saj filloi aty nga viti 1897 dhe zgjati rreth dy vjet. E projektuar nga Franz Heinrich Schwechten, një prej arkitektëve më të njohur gjermanë të epokës wilhelmiane, i cili pat kontribuar, gjithashtu, në progresin e arkitekturës historike, Grunewaldturm, është rreth 56 metra e lartë mbi lumin Havel. Në vitin 1897 bashkia e Teltovit, në rajonin e Brandenburgut, kërkoi ndërtimin e një kulle historike në përkujtim të ditëlindjes së 100-të të perandorit gjerman Wilhelm I-rë. Më 9 qershor 1899, ajo nisi rrugëtimin e pelegrinazhit përkujtimor me mbishkrimin "Kulla e perandorit Wilhelmi i I-rë ", edhe pse në fasadën lindore të saj lexon: "Në kujtim të mbretit Wilhelm i I-rë", sepse ai ishte edhe mbret i Prusisë. E projektuar në epokën e revolucionarizimit të tullave gotike, Grunewaldturm nis në hyrje të saj me një sallë jo fort të madhe, në mes të së cilës gjendet një statujë mermeri e Wilhelm të I-rë, ndërtuar nga skulptori Ludvig Manzel. Gjermanikët, kisha lexuar kohë më parë se ishin kopracë kur flitej për administrimin e markës së tyre, por prej vizitave në muzetë dhe këndeve të tjera historike rrotull landeve të kësaj toke, kupton se përmasat luksoze të artit vërtet mund të mos i kenë pasur si ato të Rilindjes Europiane, por kënaqësitë çfarë shpirti u ka kërkuar duket që s'i kanë kursyer asfare. Katër relieve hekuri me figurat e shtetarëve prusianë si Albrecht von Roon, Helmuth von Moltke, Otto von Bismarck dhe Princi Frederik Charles janë vendosur në muret e saj. Prej aty ngjitja prej shkallares në stilin gotik drejt lartësisë të çon në një platformë, prej së cilës shtrihet një pamje panoramike mbi pyllin Grunewald. Diku pranë kullës, aty poshtë syri të kap një restorant dhe përbri një kopsht birre të tundon drejt lëshimit të lirë të vetes prej aromës së majasë që vjen nga poshtë. Por kjo vetëm një fluturim çasti, sepse magjia që rrezet e diellit të sjellin ndër sy, kur petku i mëndafshtë i lumit Havel është përballë teje, të rrëmben pa kuptuar dhe gjithë gjindja jote i dorëzohet ajrit mbi gjelbërimin përkëdhelës të Grunewaldit magjepsës. Kjo kullë historike e ndërtuar edhe me shqisën e mirë për të ngacmuar muza poetësh në fund të shek. XIX-të, të kujton dhe frymën përparimtare mbi ndjenjën kombëtare të shprehur prej mendimtarëve më të mëdhenj të së kaluarës gjermanike të asaj epoke, të cilët mbetën kundërshtarë të thekur të çdo lloj shovinizmi, por të hapur miqësisht ndaj botës mbarë. Kur i kthehem historisë kujtoj se kjo nismë e tyre nuk ishte kaq individuale në të vërtetë. Familja perandorake ishte vazhdimisht e shqetësuar për zhvillimet shoqërore ndaj ajo u kërkonte shkrimtarëve gjermanë apo dhe mendimtarëve të luanin një rol etiko-politik mjaft të nevojshëm asokohe. Kish nisur kështu lufta për ndjenjën e bashkimit kombëtar gjerman, por dhe për paqen në tërësi. Luftërat me fuqinë ruse e kishin lodhur jo pak perandorinë prusiane.

Grunewaldturm, është një vend që të zgjon prej leximeve të ngjarjeve prej të cilave ajo është menduar të projektohet. Anijet që përshkojnë lumin Havel diku poshtë teje të bëjnë të ëndërrosh larg, sepse ky vend duket të jetë një festë e garantuar për disa orë ose për aq kohë sa sikush prej nesh dëshiron të qëndrojë. Prej andej ëndërrimet nuk mbarojnë këtu, sepse vendasit urtësisht sugjerojnë shëtitjen nëpër "pyllin epik", siç ata e quajnë, dhe pastaj autobusin me numrin e brishtë '218', por me emrin e bukur 'Dream Liner' për t'u kthyer në qytet. Ndoshta, sepse pa dyshim ky është dhe udhëtimi më i bukur me autobus në Berlin.

Opinioni i Ditës

# "Kanabizimi" i universiteteve publike

## *Me shkas nga një koncert i Orkestrës Simfonike të RTSH*

Nga Valbona NATHANAILI

*(Vijon nga faqja e parë)*

... Televizionit Shqiptar, nën drejtimin e regjisorit Uwe Theimer, dha një koncert me muzikë klasike. Muzikë e shkëlqyer dhe interpretim i mrekullueshëm! Por... dhe gjithmonë ka një "por" sa herë bëhet fjalë për universitetet publike, në mes të koncertit ikën dritat... Po, ikën dritat! Situata u përballua me sukses falë përgatitjes së muzikantëve dhe mbështetjes së publikut, por të paktë, besoj, kanë qenë ata spektatorë, që nuk iu mbushën sytë me lot dhe nuk u ngritën në këmbë kur muzikantët vazhduan të luanin me të njëjtën harmoni deri në fund të pjesës, një shfaqje për të cilën orkestrat e tjera kërkojnë muaj për t'u përgatitur. Përfundimi është se pas kësaj ngjarje nuk je më spektatori që ke vajtur për të kaluar një mbrëmje të bukur. Pa dashje fillon të bëhesh edhe më i vëmendshëm dhe sheh gjëra që më parë edhe mund t'i kapërdije: hapësira ndërmjet rreshtave të karrigeve ku ulen spektatorët të kujton radhët për të blerë qumësht në vitet 1980, kaq e vogël është distanca nga një rresht në tjetrin, karriget janë të vjetra dhe kanë kohë pa u rinovuar, ndërkohë që karriget ku ulen orkestrantët janë prej plastike, nga ato që gjen me shumicë në lokalet e zakonshme buzë ndonjë plazhi të humbur, si dhe plot të tjera.




Dhe me këtë shkas hap faqen online të Universitetit të Tiranës - të dhënat sipas dt. 30.10.2017. Faqja ka shumë mangësi dhe është me paraqitjen më modeste krahasuar me faqet online të universiteteve private, ndërkohë që faqet e universiteteve në rrethe janë edhe më dëshpëruese. Në një analizë shumë të thjeshtë, megjithëse faqja është shqip, nuk kanë mundur të gjejnë sinonimin shqip për fjalën "event", që gjithsesi në këtë kategori përmblidhen kryesisht dhe vetëm në takimet që ka zhvilluar rektori me homologë të tij, faqja e projekteve shkencore (si nënkategori e K. Shkencor) "është në ndërtim", domethënë nuk raporton asnjë projekt shkencor i zhvilluar nga Universiteti i Tiranës deri më vitin 2017 (!?), ndërsa "Aktivitetet Kërkimore-Shkencore" (përsëri si nënkategori e K. Shkencor) raporton në total vetëm pesëmbëdhjetë të tillë (e theksoj që bëhet fjalë për gjithë universitetin), për periudhën 2013-2014, të tipit konferenca shkencore mbajtur në vetëm 4 fakultete, nga 6 që përfshin ky universitet. Periudha 2015-2017 dhe ajo përpara vitit 2013 është "tabula rasa".

Disa vite shkollore kam dhënë leksione e seminare në Universitetin e Tiranës, në të dyja drejtimet e mia, fizikë e shkenca edukimi, ndërkohë që vazhdimisht kam pasur bashkëpunime shumë të mira me pedagogë e drejtues të këtij universiteti, veçuar ata të Universitetit të Arteve, dhe pohoj me forcë këmbënguljen e tyre për të dhënë maksimumin, kur pak gjasa ka të të njihen pasioni, përgatitja, vullneti, përkushtimi dhe asnjë gjasë të shpërblehesh e promovohesh, sepse në fund të ditës, përveç shumë problemeve që ka sjellë mënyra e organizmit dhe e administrimit që ofron ligji i arsimit të lartë, rasti i sallës së mësipërme, në fakt, mund të jetë një nga më pak problematikët. Sipas ligjit për arsimin e lartë, universitet publike janë projektuar të administrohen, pjesërisht, sipas modelit të universiteteve private, por pa parashikuar vështirësitë që mund të kishte një model i tillë, apo sa efikas do të ishte. Pra, synimi mund të ketë qenë i mirë, por rezultati shumë i keq. Në rastin e universiteteve private, administratori që është përgjithësisht edhe pronari ose një njeri i besuar i tij, udhëheq me dorë të fortë dhe të hekurt. Në universitetet publike, administratori është thjesht personi i punësuar. Ligji për arsimin e lartë sigurisht duket i bukur në këtë drejtim, sepse ka një bord që e zgjedh dhe e kontrollon, po aq sa e pushon kur nuk punon si duhet, por sigurisht për shkak të një numri shumë të madh burokracish e eksperimentesh me të punësuar, rezultatet tregojnë se nuk mund të ketë barazi ndërmjet administratorit të një universiteti privat dhe atij të një universiteti publik: i pari është i plotfuqishëm në çdo gjë dhe nën drejtimin e tij të gjithë këndojnë në kor me vetëm një zë, ndërsa i dyti është i punësuari radhës (meqenëse po flasim për administratorë, Universiteti i Tiranës po kërkon të punësojë një administrator të ri). Akoma, në universitetet private ka një lidhje shumë harmonike ndërmjet administratës dhe personelit akademik. Në përgjithësi politika është që të ketë bashkëpunime sa më të ngushta ndërmjet tyre: mbledhje e raportime pothuaj të përditshme dhe shpesh pedagogët janë në rolin e administratorëve të niveleve të ndryshme dhe anasjelltas. Në universitet publike këto janë të ndara dhe shumë larg nga njëri-tjetri, në mos edhe krejtësisht të huaj për njëri-tjetrin. Për t'i pasur më të thjeshta arsyetimet e konkluzionet, po sjell edhe një shembull tjetër nga universitetet private: në këto universitete ekzistojnë zyrat e projekteve (në formën e OJF-ve, për shembull institut, qendër, fondacion etj.), me disa të punësuar me kohë të plotë, ku detyra e secilit prej tyre është të hapë e mbyllë gjithë ditën çdo faqe online institucioni, privat a publik, në formën e një shoqërie fitimprurëse a jo fitimprurëse, shqiptare a të huaj dhe të identifikojnë çdo burim të ardhurash që mund të shërbejë si bazë për ngritjen e një projekti, duke filluar nga ndërtimi e arredimi i një salle shfaqjeje e deri te botimi i një manuali të zakonshëm, po aq sa të lobojë pranë njerëzve që i kanë këto pushtete. Këto para u shtohen parave që merren direkt nga kuotat e regjistrimit të studentëve. Kush ndërmerr nisma të tilla në universitetin publik?

Universiteti publik vazhdon të bëjë hije vetëm për shkak të inercisë. Nuk më habiti fare rezultati i Agjencisë së Akreditimit dhe besoj në seriozitetin e kritereve të tij. Mekanizmat e administrimit sipas ligjit për arsimin e lartë, janë të tillë që vënë barazi aty ku është e pamundur të ketë barazi dhe bëjnë dallime aty ku është e pamundur të bësh dallime ndërmjet institucioneve private e publike. Dhe të gjitha me një pasojë: degjenerimin në një të ardhme jo të largët të arsimit të lartë publik dhe zhvlerësimin e kontributeve të një armate të madhe pedagogësh që punojnë në këtë nivel.

Në Shkodër qarkullon një fjalë e urtë popullore: I zoti e jep, tellalli e mban. Ministria e Arsimit duhet të reflektojë ndaj pakënaqësive të ngritura nga ata që punojnë në këtë sektor dhe nuk mund të qëndrojë indiferente ndaj një situate për të cilën është vetë autore. Ligji për arsimin e lartë u mundëson universiteteve publike të vazhdojnë të vegjetojnë, ndërkohë që u merr cilësinë, u mohon dinjitetin, u errëson shkëlqimin dhe u zhvlerëson përpjekjet. Ligji për arsimin e lartë i ka shndërruar universitetet publike si fushat me kanabis që raporton prokuroria italiane që gjenden në Vlorë. Në fakt, të gjithë e dimë se si është gjendja dhe vetëm "ata lart" thonë që çdo gjë është në rregull. Me sa duket, duhet ndonjë skandal që të vërë në funksionim mekanizmat për ndryshimin e tij. Kambana e Agjencisë së Akreditimit i bashkohet thirrjeve të mëparshme, por me sa duket kori nuk ka marrë nota tragjike ende.

## HOROSKOPI

### DASHI

Në ndikimin e Uranit dhe Venusit priten, mbi të gjitha nëse jeni beqarë, perspektiva interesante risish në sektorin e dashurisë. Do të rrethoheni nga njerëz me të cilët ndihen mirë dhe do të mënjanoni ata që duan t'u detyrojnë zgjedhjet edhe mendimet e tyre.

### DEMI

Do t'ju duhet të përballeni me ndonjë të papritur, dhe nuk do të keni atë elasticitet që do të ishte i nevojshëm për t'u përballur me risi dhe për të riorganizuar programin. Kjo mënyrë e vazhdueshme për të pyetur të tjerët ndoshta fsheh paaftësinë për pranuar atë çka është e ndryshme nga ju.

### BINJAKET

Me Neptunin që ju mbron, mund të mbështeteni te miqësi dhe kontakte konstruktive. Jini të sigurt ,jeta juaj është duke evoluar në drejtime më interesante. Me Marsin armiqësor, kini kujdes nga gabimet në vlerësimin e sjelljeve për të mos gabuar.

### GAFORJA

Do të kaloni disa zënka dhe do t'ia dilni të tejkaloni të gjitha pengesat që ju ndalojnë të merreni vesh me partnerin e dashur. Mos i lini pas dore çështjet private për të dëgjuar dhe për të ndihmuar një person që ju kërkon ndihmë.

### LUANI

Venusi, Marsi dhe Neptuni bashkëveprojnë me Hënën në favorin e juaj. Do të njihni persona, të cilët mund t'jua vërtetojnë menjëherë vlerën dhe sinqeritetin. Po kaloni një periudhë ndryshimesh në çdo fushë. Të papriturat do t'ju bëjnë përsëri vizitë.

### VIRGJERESHA

Ndonjë zënkë më shumë dhe klima dashurore do të ndikohet ndjeshëm. Do të jetë më mirë t'i kontrolloni reagimet tuaja të gjaknxehtësisë. Një mik, vetëm për të mohuar mbështetjen e premtuar, do të përpiqet t'ju fusë dyshime për zgjedhjen e bërë.

### PESHORJA

Me favorizimin e Jupiterit, nëse jeni në kërkim të një pune, dijeni se fati mund t'ju trokasë në derë. Mos rrini duarkryq. Falë Venusit mike që ju vëzhgon, mund të hapni një kapitull të ri në lidhjet e juaja dashurore.

### AKREPI

Do të keni fërkime me një familjar që këmbëngul që gjithçka shkon mirë, ndërsa në realitet ka tensione të fshehura. Kush jeton në çift duhet të bëjë kujdes që të mos ndërlikojë atë që është e thjeshtë dhe e drejtpërdrejtë.

### SHIGJETARI

Me planetin e dashurisë që ju mbron, do të kërkoni mundësi dialogu dhe bashkëpunimi me personin e zemrës. Lidhja do të rezultojë më e forcuar. Falë Venusit që vazhdon t'ju mbrojë, nuk duhet të sforcoheni shumë për të qëndruar në formë.

### BRICJAPI

Mirëkuptimi i personave që ju qëndrojnë në krah do ta ketë të vështirë të çajë nervozizmin e juaj. Do të jetë e vështirë të ruash qetësinë ndaj atyre që vazhdojnë të bëjnë po të njëjta propozime shumë e shumë herë.

### UJORI

Hëna rrit optimizmin dhe aftësinë komunikuese. Vërtet do të jeni pak egocentrikë, por edhe të shkëlqyer dhe interesant si kurrë më parë! E dini fatin e juaj, por do të arrini edhe të përfitoni nga rasti për të mësuar nga persona vërtet të veçantë.

### PESHQIT

Plutoni jo shumë miqësor do t'ju kujtojë se duhet të ndërtoni marrëdhënie të karakterizuara nga ekuilibri i duhur midis rastësisë dhe vetëkontrollit. Vazhdoni të hani në mënyrë të shëndetshme, duke zgjedhur me saktësi ushqime të cilësisë së mirë.

SUPERLIGA




## Kamza thyen Laçin dhe ngjitet e katërta

Goli i parë sezonal i Sebino Plakut i mjaftoi Kamzës për të marrë fitoren e 2-të në transfertë dhe për t'u konfirmuar si një nga skuadrat surprizë të këtij sezoni. Në Laç, në një ndeshje që prodhoi shumë tension, vendosi gjithçka një gol i Sebino Plakut me Kamzën që mposhti 1-0 skuadrën e Gentian Mezanit, duke u ngjitur në vendin e 4-t të renditjes në kuotën e 12 pikëve, 1 më shumë se Partizani. Fitore me aromë ishte për Ramadan Ndreun. Në pjesën e parë shanset më të mira i pati pikërisht Kamza me Sebino Plakun që të 30-tën u ndal nga traversa, ndërsa disa sekonda më vonë nuk gjeti portën e Selmanit. Në minutën e 62-të kaos total në fushë me Enea Jorgjin, që nxori dy kartonë të kuq. Ndëshkoi fillimisht Nezirin me të verdhin e dytë ndërsa i drejtoi në fytyrë kartonin e kuq direkt Sefgjinajt për një gjest antisportiv ndaj Racic edhe pse Jorgji fillimisht ngatërroi lojtar duke ndëshkuar Jonuzin, por korrigjoi gjithçka pas këshillimit me anësorin. Golin e fitores Kamza e gjeti shumë vonë në të 86-tën me Plakun që i shërbyer nga Frashëri goditi saktë me kokë për t'i dhënë tre pikë shumë të rëndësishme skuadrës së Ndreut.

**SUPERLIGA**

**JAVA E 8**

| | |
|---|---|
| **TË SHTUNËN** | |
| Lushnja - Teuta | 2-1 |
| Skënderbeu - Luftëtari | 2-0 |
| **TË DIELËN** | |
| Kukësi - Vllaznia | 2-2 |
| Partizani - Flamurtari | 0-1 |
| **TË HËNËN** | |
| Laçi - Kamza | 0-1 |

"Big Luçiano" vlerëson lojtarin, por nuk mund të presë pafundësisht rikthimin e tij në fushë

# Moxhi 'kërcënon' Çanin: Riaftësohu ose largohu

## *Drejtori i Partizanit futet në merkato për sulmin*



Jeton Selimi




Drejtuesit e Partizanit zhvilluan paraditen e sotme një mbledhje, ku analizuan situatën në të cilën ndodhet klubi i kuq. Italiani nuk i ka kursyer pakënaqësitë ndaj sulmuesit Edgar Çani, i cili u afrua me shumë bujë te "Demat e Kuq". Ja fjalët e Moxhit: "Na vjen keq që nuk fituam dot, por mendoj se kemi një problem në sulm! Për fat të keq gjuajtëm vetëm një herë në portë dhe kur nuk ke një sulmues që finalizon punën e skuadrës, atëherë bëhet më e vështirë! Do të shohim nëse Çani do të rikuperohet në kohë apo jo, por në të kundërt duhet të shohim për një sulmues tjetër! Kam respekt për Çanin, por edhe respekti ka një kufi zgjat aq sa mund të zgjasë! Tani mendoj se duhet të flasim edhe në aspektin profesional dhe këtu ndryshon biseda me Çanin! Do shohim çfarë do të ndodhë në të ardhmen, sepse edhe kështu nuk shkon…",-tha Moxhi për "Panorama Sport" pas mbledhjes!

Paraditen e djeshme në ambientet e klubit Partizani u zhvillua një mbledhje me stafin ku u analizua ecuria e skuadrës dhe humbja ndaj Flamurtarit. Në një prononcim pas mbledhjes, drejtori sportiv i të kuqve, Preiti, konfirmoi trajnerin Iuliano në stolin e kryeqytetasve.

"Zhvilluam një mbledhje me stafin e Partizanit për të analizuar ecurinë e skuadrës. Humbjet janë gjithmonë të shëmtuara, jo të bukura. Por, është mëkat, sepse në pjesën e parë bëmë mjaft mirë, ndërsa në të dytën më shumë ishim konfuzë se sa luajtëm. Ata u mbrojtën mirë dhe morëm trepikëshin. Merita e atyre, por edhe ne patëm gabime. Nuk ishte vetëm për humbjen e ndeshjes së fundit! E theksoj këtë! Ishte një takim konsultativ mes nesh për të kuptuar më mirë edhe se ku kemi diçka për të riparuar! Stafi i Partizanit nuk preket! Është i konfirmuar! Një klub serioz nuk duhet të diskutojë stafin në një projekt që sapo ka nisur! Natyrisht na vjen keq për humbjen dhe për pikët që nuk janë aty ku dëshiron dhe meriton Partizani, por gjithsesi diferenca me ekipet e tjera nuk janë aq të mëdha. Këtu bën përjashtim vetëm e para në klasifikim që po ecën mjaft mirë. Pjesa tjetër nuk kanë diferenca të mëdha",- tha Preiti.

FAIR-PLAY FINANCIAR




## La Liga, kërkesë BE-së për përjashtimin e PSG-së dhe Sitit

Drejtuesit më të lartë të La Liga kërkojnë sanksione të rënda ndaj klubeve të PSG-së dhe Mançester Sitit për thyerje të rregullave të Fair Play Financiar. Spanjollët do t'i drejtohen Bashkimit Europian duke kërkuar një vendim të paprecedent, për përjashtimin e këtyre skuadrave nga aktivitetet europiane. Presidenti i La Liga, Havier Tebas, tregoi për "L'Equipe" se që në muajin gusht ka dërguar në UEFA një dosje të plotë me shkeljet e ndryshme ku sinjalizohet se si PSG financohet në mënyrë të parregullt nga shteti i Katarit. "Kemi parë se si PSG dhe Mançester Siti kanë investuar më shumë se çdo klub tjetër në 5 vitet e fundit, por të ardhurat e tyre reale nuk mund të justifikojnë kurrsesi këto investime që kanë bërë. Ata kanë përfshirë sponsor fiktivë, që kanë lidhje me shtetet që kontrollojnë klubet dhe ku investohen shuma më të mëdha se sa ato te Real Madrid, Barcelona, Bajern Mynih apo Mançester Junajtid. Të ardhurat janë të lidhura direkt me shtetin e Katarit në rastin e PSG-së dhe në këtë mënyrë, klubi po mashtron me të dhënat financiare duke mos iu nënshtruar rregullave si të gjithë të tjerët", - shpjegoi Tebas.

## Përjashtohet Dosti, gjobitet Hila, konfirmohet Magani

**FURTUNË TE TEUTA**




Ka ndodhur ajo që pritej. Drejtuesit e Teutës kanë marrë masa konkrete pas mbledhjes së fundit dhe kanë përjashtuar nga ekipi mesfushorin Albi Dosti, i cili ishte kthyer në verë te durrsakët. Lajmin e konfirmon faqja zyrtare e klubit. Të dielën në mbrëmje është konfirmuar qëndrimi i trajnerit Gugash Magani, ndërkohë që Ardit Hila është gjobitur financiarisht nga drejtuesit e Teutës. Furtuna ishte paralajmëruar, pas rezultateve të dobëta të Teutës në javët e fundit. Trajneri Magani dha dorëheqjen pas humbjes në Lushnjë, por presidenti Hasanbelliu e bindi të vazhdojë punën. Albi Dosti e ka mbyllur kështu aventurën e fundit me fanellën e Teutës, pas 8 javësh kampionat. Masë është marrë edhe për elbasanasin Hila, por vetëm gjobë dhe jo përjashtim.

VLERËSIMI

## Strakosha, i dyti në Serie A, në specialen e "Gazzetta"-s

Thomas Strakosha po kalon te Lacio momentin më të mirë të karrierës së tij. Portieri i kombëtares sonë është kthyer në një nga futbollistët më të rëndësishëm te skuadra bardhekaltër. "La Gazzetta dello Sport", së fundmi ka publikuar një speciale për portierët me përqindjet më të larta të pritjeve gjatë këtij sezoni. Numri një i portës së Lacios renditet në vendin e dytë pas portierit të Romës Alison, i cili ka arritur që të presë 86.5 për qind të gjuajtjeve. Strakosha ndërkohë ka pritur 78.9 për qind të gjuajtjeve të bëra në këtë fillim sezoni. Nuk kanë qenë të pakta rastet kur mediat italiane kanë filluar që ta quajnë si një mur gjatë këtij sezoni, ndërkohë që të tjerë e kanë cilësuar si pasuesin ideal të Bufonit te Juventusi. Në listën e portierëve më të mirë është edhe Berisha, i cili ka pritur 60 për qind të gjuajtje, më mirë se Donaruma i Milanit.




www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
GSH.AL
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
GSH
www.gsh.al
Tashmë edhe lundroni!
GAZETA SHQIPTARE
KRIZA POLITIKE, SOT TAKIMI RAMA-BASHA
Agron Duka: Ju rrëfej darkën në Mullet me Fatos Nanon
Sherri për kutshët, Roza Lati: Do t'i jap kastravecë
BLUE TOOTH
500 NUMRA, NJE HISTORI SUKSESI
SUMMER
DORINA GEGIÇI
Çdo profesion ka nevojë për talent, jo sponsor
A e meriton Shën Tereza një muze në Shqipëri?!